



ORGANET E DREJTËSISË NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Raport

Nga monitorimi i veprimtarisë së organeve të drejtësisë në rrethet
Tiranë, Vlorë, Shkodër, për çështjet penale që lidhen me korrupsionin
(Periudha e monitorimit: 2004-2006)

Ky botim është përgatitur nën shqyrtimin e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Ai u hartua nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadrin e programit të USAID-it për Shtetin Ligjor në Shqipëri.

TIRANË
Qershor, 2007

Raporti u realizua në kuadër të zbatimit të projektit “Rritja e aksesit të shtetasve në organet e drejtësisë për zbatimin me efektivitet të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”, financiar dhe mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, (USAID) me anë të Programit të Shtetit Ligjor¹.

USAID Kontrata me Nr. 2103-03-CLCI

USAID Programi i Shtetit Ligjor në Shqipëri

Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”

Sky Tower, Suite 13/3, Tiranë

Tel.: +355 422 1666 Ext.123

Fax: +355 422 1666 Ext.192

Raporti u hartua nga ekspertët:

Prof. As. Vasilika Hysi

Prof. Dr. Aurela Anastasi

Dr. Altin Shegani

Jola Xhafo (master)

Me mbështetjen teknike të ekspertëve:

Av. Besa Saraci

Av. Sofia Koco

Av. Aurela Bozo (Koordinatorë e projektit)

Arti grafik: Eranda Ndregjoni

E drejta e autorit: QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE (QNL)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e botuesit.

ISBN:

Nëse jeni të interesuar për këtë botim, mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme:

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Adresa: Rr.”Vaso Pasha”, Pall.12, Shk.1, Ap.1, Tiranë-Shqipëri

Tel: 00355 4 259795, Fax: 00355 4 241914

¹ REFUZIM

Përmbajtja është përgjegjësi e autorëve/QNL dhe pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

PËRMBAJTJA

Parathënie

KREU 1 STUDIMI DHE METODOLOGJIA E TIJ

- 1.1 Hyrje
- 1.2 Objektivat kryesorë të studimit
- 1.3 Objekti i studimit
- 1.4 Baza ligjore dhe metodologjia e përdorur në studim

KREU II PËRQASJA E LEGISLACIONIT SHQIPTAR ME STANDARTET NDERKOMBËTARE DHE PROBLEMATIKA E ZBATIMIT TË TYRE NË LUFTEN NDAJ KORRUPSIONIT

- 2.1 Reforma ligjore në fushën penale.
- 2.2 A ka qenë efikase kjo reformë ligjore në goditjen ndaj korrupsionit?

KREU III DISA TË DHËNA TË DALA NGA MONITORIMI I PROCEDIMEVE ADMINISTRATIVE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT

- 3.1 Hyrje
- 3.2 Masat disiplinore të marra nga vetë institucioni ndaj punonjësve të tij

KREU IV VËSHTRIM KRIMINOLOGJIK I PROCEDIMEVE PENALE NË FUSHËN KUNDËR KORRUPSIONIT

- 4.1 Prokuroria- organ i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit
- 4.2 Të dhënat e monitorimit të procedimeve penale në prokurorinë e rrethit Tiranë,
Vlorë dhe Shkodër
- 4.3 Mënyra e përfundimit të procedimeve penale

KREU V VËSHTRIM PRAKTIK I MONITORIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE TIRANË, SHKODËR DHE VLORË

- 5.1 Veprat penale të korrupsionit dhe gjykatat shqiptare
- 5.2 Veprat penale të korrupsionit të gjykuara në gjykatat objekt –monitorimi
- 5.3 Disa karakteristika social-demografike të të gjykuarve për veprat penale të korrupsionit

- 5.3.1 Personat e gjykuar për vepra penale të korrupsionit sipas gjinisë
- 5.3.2 Personat e gjykuar sipas grup moshave
- 5.3.3 Arsimimi i të gjykuarave për veprat penale të korrupsionit
- 5.3.4 Vendbanimi i personave të gjykuar
- 5.3.5 Profesioni i personave të gjykuar dhe institucionet ku punojnë
- 5.3.6 Disa të dhëna në lidhje me akuzën dhe llojin e dënimit në gjykatat e monitoruara
- 5.3.7 Dënimi dhe zbatimi i tij ndaj personave që kanë kryer vepër penale të korrupsionit
- 5.4 Statusi i personave të gjykuar
- 5.5 Ankimimi kundër vendimeve gjyqësore në fushën e veprave penale të korrupsionit

KREU VI PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

ANEX

1. KODI PENAL (VEPRAT PENALE PERKATESE)

2. *“Korrupsioni në Shqipëri: shkaqet, pasojat dhe lufta ndaj tij nëpërmjet zbatimit të legjislacionit”*. Ese përgatitur nga studenti i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës Albana Alimema. Vlerësuar me çmimin e parë në konkursin e organizuar “Eseja më e mirë e studentit të drejtësisë”, në kuadër të këtij projekti.

3. FALENDERIME TË GJITHË SPECIALISTËVE DHE STUDENTËVE TË POSHTËSHËNUAR, QË KONTRIBUAN PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE TË KËTIJ PROJEKTI

4. FOTO NGA AKTIVITETET E ORGANIZUARA

PARATHËNIE

Raporti që po paraqesim është rezultat i një pune 6-mujore monitoruese, në kuadrin e zbatimit të projektit: *“Rritja e aksesit dhe besimit të qytetarëve në organet e drejtësisë përmes zbatimit efektiv të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”*

Nisma për të monitoruar veprimtarinë e organeve të drejtësisë në çështjet që lidhen me korrupsionin, ishte rrjedhojë e problemeve dhe pikëpyetjeve që Qendra jonë haste përditë në punën e saj, lidhur me besimin e publikut për të denoncuar veprat korruptive dhe autorët e tyre pranë organeve të drejtësisë. Për më tepër, vinim re se qytetarët i stigmatizonin dhe paragjykonin këto organe, si organe të prekura edhe ato vetë nga korrupsioni. Prandaj, monitorimi ynë pati si qëllim evidentimin e praktikave të ndjekura nga Prokuroria dhe Gjykata, për të gjykuar dhe goditur veprat penale që lidhen me korrupsionin (gjithsej 12 vepra penale), duke i bërë ato të njohura për publikun. Në këtë mënyrë, mund të ndikojmë në rritjen e besimit të publikut dhe në informimin e këtij të fundit. Qëllimi kryesor mbetet nxjerrja e konkluzioneve për të rritur mundësinë e shtetasve për denoncimin e korrupsionit në organet e drejtësisë, dhe për të dhënë ndihmesë reale në zbatimin me efektivitet të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.

Fusha e studimit është kufizuar në vitet 2004-2006 dhe është përqendruar në tri rrethe: Tiranë, Shkodër, e Vlorë. Raporti përmban disa pjesë, të cilat në koherencë me njëra-tjetrën, realizojnë synimet që i kishim vënë vetes në kuadër të këtij projekti. Analiza e legjislacionit ekzistues për ndëshkimin e veprave që lidhen me korrupsionin, si dhe krahasimi i saj me standardet e parashikuara nga aktet ndërkombëtare dhe me përvojën e vendeve të tjera të përparuara në luftën kundër korrupsionit, do të ndihmojë në përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe përafrimin e tij me atë ndërkombëtar.

Evidentimi i çështjeve dhe problemeve që dalin nga zbatimi i legjislacionit në praktikën e organeve të drejtësisë (Prokurori, Gjykatë) dhe atyre administrative, si dhe krahasimi i veprimtarisë së aktorëve që u monitoruan gjatë zbatimit të projektit, ka sjellë të dhëna e konkluzione të reja për efektivitetin e zbatimit të ligjit. Përgjithësimet, konkluzionet e dala nga monitorimi në praktikën hetimore dhe atë gjyqësore, do të ndihmojë në përmirësimin e praktikave të vetë organeve të drejtësisë, si dhe të organeve që i kontrollojnë ato. Konkluzione të rëndësishme kanë dalë edhe nga monitorimi në aspektin *gender*, gjë që ka sjellë një vizion të ri të analizës në këtë këndvështrim.

Një kënaqësi të madhe gjatë zbatimit të gjithë projektit, na ka dhënë bashkëpunimi me studentët e Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Shkodrës. Qëllimi ishte që gjithë puna jonë, praktika dhe ndjeshmëria e monitorimit të përcilleshin edhe tek brezi më i ri që u përfaqësua nga studentët e Drejtësisë. U krijua dhe u trajnuar skuadra monitoruese, e cila kreu me sukses detyra të monitorimit të praktikave të prokurorisë dhe Gjykatës në Tiranë, e Vlorë. U krye dramatizimi i gjyqit imitues nga studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Shkodër. Kjo përvojë, shërbeu për të na dhënë edhe 12 esetë më të mira, të përgatitura nga studentët. Aktivizimi i tyre do të

ndihmojë në mënyrë reciproke edhe në aftësimin dhe ndërgjegjësimin për të ardhmen, jo vetëm si qytetarë, por edhe si profesionistë të organeve të drejtësisë.

Gjatë punës monitoruese u përkujdesëm që të evidentonim jo vetëm problemet e veprimtarisë së organeve të drejtësisë, por edhe të zbatimit të një procesi gjyqësor të drejtë e të ndershëm, me qëllim respektimin e mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore gjatë këtij procesi.

Deri tani, publiku e ka perceptuar korrupsionin dhe përmasat e tij, vetëm përmes sondazheve subjektive të atij vetë, nisur nga ndodhitë personale, ose nga ndodhitë e dëgjua. Ky studim, do të sjellë një perceptim të korrupsionit mbi një bazë krejt të re dhe një mundësi të re të perceptimit të tij në organet e drejtësisë. Kjo sepse, premisa për të arritur në konkluzione në lidhje me të, mbetet se sa ky fenomen është denoncuar përpara organeve të drejtësisë, dhe sa ky fenomen është goditur nga këto organe.

Bashkëpunimi që Qendra jonë krijoi për zbatimin e këtij projekti me Departamentin e të drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ka rrjedhoja shumë të mira, në përgatitjen e raportit, si dhe në rritjen e nivelit të tij për shërbyer edhe si një studim i denjë për përmirësimin e literaturës dhe të doktrinës juridike për këtë problem. Duhet pranuar, se edhe studimet akademike në këtë fushë kanë qenë mjaft të kufizuara, prandaj shpresojmë që ky raport dhe faktet e pasqyruara në të, të shërbejnë për nxitjen e tyre dhe për referenca reale. Këto studime, padyshim, nuk mund të mbeten si qëllime në vetvete, por do të shërbejnë më shumë për kualifikimin e profesionistëve të sistemit të drejtësisë.

Evidentimi në këtë punim i të dhënave statistikore dhe identifikimi i problemeve të ndryshme në kuadrin e veprimtarisë së organeve të drejtësisë, na kanë dhënë mundësi, jo vetëm të japim informacion në lidhje me goditjen e këtij krimi nga gjykatat, por edhe të arrijmë në disa përfundime të rëndësishme, duke rekomanduar përmirësime të kuadrit ligjor si dhe të praktikave të ndjekura nga organet e drejtësisë.

Ky punim u ofron ndihmë modeste të gjitha strukturave shtetërore që hartojnë dhe zbatojnë politikat në luftën kundër korrupsionit, që kryejnë reformat ligjore dhe japin ekspertiza të ndryshme në këtë fushë.

Për sa më sipër, mendojmë se punimi do t'u shërbejë së pari, punonjësve të sistemit të drejtësisë, veçanërisht gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve. Kuptimi dhe zbatimi më i drejtë i legjislacionit tonë penal dhe i akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, kërkojnë veprimtari më të kualifikuar prej tyre.

Një moment tjetër i rëndësishëm mbetet kualifikimi dhe ndërgjegjësimi i mëtejshëm i juristëve dhe i punonjësve të tjerë të sistemit të institucioneve publike, të cilët janë të parët që ndeshen me denoncime për shpërdorim të detyrës dhe afera korruptive. Denoncimi i kryer nëpërmjet tyre ka nevojë për veshje të re profesionale, pasi numri i vendimeve për mos fillim të çështjeve penale rezultoi shumë i lartë.

Do të ishte kënaqësi e veçantë për ne, nëse ky punim do të ndihmonte sadopak kolegët e organizatave jofitimprurëse që punojnë në këtë fushë. Këndvështrimi ynë i posaçëm mund të hapë për ta vështrime të reja, jo vetëm për identifikimin e problemeve, por edhe për shërbimin që ata ofrojnë për qytetarët, me qëllim aksesin e këtyre të fundit, ndaj organeve të drejtësisë.

Radha e falënderimeve për të gjithë ata që ndihmuan në zbatimin e këtij projekti dhe hartimin e këtij raporti, vjen në fund, por është mjaft e rëndësishme për ne, pasi mirënjohja është më e pakta për të gjithë ata, pa ndihmën e të cilëve nuk mund të realizohej ky punim.

Gjejmë rastin të falënderojmë të gjithë ekspertët që punuan për realizimin e këtij punimi, për ekspertizën që na dhanë gjatë gjithë realizimit të projektit, si dhe të gjithë stafin ndihmës.

Pa ndjekur ndonjë rregull të caktuar në radhë, falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta të organizuara nga Qendra jonë, në Tiranë, Vlorë e Shkodër, të cilët, nëpërmjet diskutimeve e mendimeve të tyre, na ndihmuan mjaft për përmirësimin e këtij botimi.

Një falënderim të veçantë kemi për të gjithë drejtuesit e gjykatave dhe të prokurorive, në Tiranë, Vlorë e Shkodër, veprimtaria dhe vendimet e të cilave u bënë objekt i monitorimit, për gatishmërinë që treguan dhe ndihmën që na dhanë duke lehtësuar punën.

Ky botim nuk do të mund të realizohej pa mbështetjen dhe inkurajimin e dhënë nga programi USAID, Ndihma e Popullit Amerikan për Shqipërinë, të cilët i falënderojmë dhe u shprehim mirënjohjen tonë.

Prof. dr. Aurela Anastasi

Drejtoreshë ekzekutive

KREU I

STUDIMI DHE METODOLOGJIA E TIJ

1.1 Hyrje

Korrupsioni është një fenomen shqetësues për shoqërinë shqiptare. Në vitin 2003, Shqipëria u rendit vendi i 92 nga 133 vende gjithsej; në vitin 2004, u rendit vendi 108, nga 145 vende gjithsej dhe, në vitin 2005, vendi 127 ndër 158 vende, në të njëjtin nivel me Rusinë, Nigerinë dhe Sierra Leone.

Sipas një sondazhi të kryer nga IDRA² në vitin 2005 (i bërë publik në qershor 2006), nga 17 institucione dhe grupe të studiuara sipas perceptimeve të publikut grupet më të korruptuara ishin: *deputetët, nëpunësit e doganave dhe tatimeve, mjekët dhe gjyqtarët*. Grupet më pak të korruptuara rezultojnë: Presidenti i Republikës, udhëheqësit fetarë dhe ushtarakët.

Në kuadrin e luftës kundër korrupsionit, pas viteve '90 janë ndërmarrë një sërë masash me karakter ligjor, institucional dhe sensibilizues. Këtij qëllimi i ka shërbyer ratifikimi nga shteti shqiptar i një tërësie instrumentesh ndërkombëtare në fushën e korrupsionit, si:

1. Konventa civile "Për korrupsionin", ratifikuar me Ligjin Nr. 8635, datë 06.07.2000
2. Konventa penale për korrupsionin, ratifikuar me Ligjin Nr. 8778, datë 26.04.2001
3. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, ratifikuar me Ligjin Nr. 9492, datë 13.03.2006

Këshilli i Evropës ka hartuar instrumente ligjore dhe tekste të tjera bazë në lidhje me antikorrupsionin, ndër të cilat mund të përmendim si mjaft të rëndësishme:

1. Konventa për pastrimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi³,
2. Rezoluta (97) 24 për 20 parimet e luftës kundër korrupsionit,
3. Rekomandimi R (2000) 10 për kodin e sjelljes së nëpunësve publik.

Gjithashtu, Shqipëria është bërë pjesë e zhvillimeve ndërkombëtare rajonale në këtë fushë. Këshilli i Evropës ka ngritur një mekanizëm kontrolli (GRECO) për të monitoruar zbatimin e parimeve bazë në luftën kundër korrupsionit dhe zbatimin e instrumenteve të tjera ndërkombëtare në përputhje me Programin e veprimit kundër korrupsionit.

² Instituti per Kerkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA)

³ Kjo konventë është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 9646, datë 27.11.2006.

Shqipëria ka marrë pjesë në programe të ndryshme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në vendet e Evropës Juglindore (PACO), si dhe në programe të tjera që zbatohen nga organizatat ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri. Në kuadrin rajonal, Shqipëria është palë e iniciativës së SPAI-t (Iniciativa Antikorrupsion e Paktit të Stabilitetit) e nisur në shkurt të vitit 2000 në Sarajeve me pjesëmarrjen e 8 shteteve të rajonit.

Kodi penal i vitit 1995 në krahasim me kodin e mëparshëm, rregulloi më mirë veprat penale të kryera nga punonjës shtetërorë ose në shërbimin publik. Megjithatë ishte një kod i ri, kjo pjesë e tij iu nënshtrua ndryshimeve dhe përmirësimeve në vitin 2001 dhe 2004.

Lufta kundër korrupsionit është objektivi kryesor i Qeverisë shqiptare. Vihet re angazhimi i saj për të ndërmarrë reformat e nevojshme në luftën kundër korrupsionit. Pjesë e përpjekjeve të shoqërisë shqiptare është edhe sensibilizimi i publikut për të krijuar një mjedis mbytës kundër korrupsionit, si dhe monitorimi i institucioneve të ndryshme, përfshirë edhe sistemin e drejtësisë, për të qenë transparent, efektiv dhe në shërbim të publikut.

Ky studim përbën një kontribut modest në këtë drejtim.

1.2 Objektivat kryesore të studimit

Monitorimi i procedimeve penale dhe vendimeve gjyqësore të gjykatave të rretheve Tiranë, Vlorë dhe Shkodër synon të kontribuojë në mënyrë modeste në rritjen e nivelit të informimit të qytetarëve për legjislacionin shqiptar kundër korrupsionit, në veçanti atë penal e procedural penal; në nxitjen e publikut për denoncimin, parandalimin dhe ndëshkimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin, si dhe në parandalimin e përfshirjes së vetë viktimave në këto vepra penale.

Monitorimi i veprimtarisë së organit të prokurorisë dhe të gjykatës nga një organizatë e pavarur jashtë sistemit gjyqësor synon të rrisë përgjegjshmërinë e strukturave përkatëse shtetërore, sidomos gjykatës e prokurorisë, në ndjekjen penale, gjykimin dhe ndëshkimin e akteve kundër autoritetit të shtetit, të kryer nga zyrtarët shtetërorë ose në shërbime publike, si dhe akte të tjera në lidhje me korrupsionin (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë).

Analiza e legjislacionit ekzistues për ndëshkimin e veprave që lidhen me korrupsionin nuk është qëllim në vetvete, por synon në përmirësimin e tij dhe në zbatimin më të mirë, në praktikë. Nga ana tjetër, evidentimi i problemeve që dalin nga zbatimi i legjislacionit në praktikën e organeve të drejtësisë (prokurori, gjykatë), si dhe në ato administrative, do të mundësojë nxjerrjen e përfundimeve dhe bërjen e rekomandimeve përkatëse në këtë fushë.

Për aq sa është e mundur, studimi i çështjeve penale në fushën e korrupsionit në këndvështrimin gjinor, do të mundësojë hartimin e programeve më efektive për parandalimin e këtij fenomeni në radhët e grave.

1.3 Objekti i studimit

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon disa figura veprash penale në fushën e korrupsionit si: korrupsioni aktiv (mitëmarrja) e personave që ushtrojnë funksione publike (nenet 244 i k.p)⁴, korrupsioni aktiv (mitëmarrja) e funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë (neni 245 i k.p), ushtrimi i ndikimit ndaj personave që ushtrojnë funksione publike (245/a i k.p), shpërdorimi i detyrës (neni 248, i k.p), shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti (neni 256 i k.p), korrupsioni pasiv (mitëmarrja) e personave që ushtrojnë funksione publike (nenet 259 i k.p), korrupsioni pasiv (mitëmarrja) e funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë (neni 260 i k.p), korrupsioni aktiv (mitëmarrja) i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë (nenet 319 i k.p), korrupsioni pasiv (mitëmarrja) i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë (neni 319/a i k.p) dhe dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve (neni 328 i k.p)

Objekti i monitorimit u bënë të gjitha këto vepra, porse më tepër u gjetën vendime në lidhje me shpërdorimin e detyrës (neni 248 i kodit penal), me korrupsionin pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259 i k.p), me korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë (neni 260 i k.p), si dhe me marrjen e mitës (neni 260 i k.p)⁵ e kryerjen e veprimeve arbitrare (neni 250 i k.p).

Në kuadër të projektit janë monitoruar procedimet penale të prokurorive të rretheve Tiranë, Vlorë dhe Shkodër dhe vendimet gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, Vlorë dhe Shkodër të dhëna gjatë periudhës 2004-2006.

Krahas këtyre vendimeve u monitorua edhe veprimtaria administrative e Drejtorisë Rajonale Tiranë (ish-Zona e Shpërndarjes Elektrike Tiranë), në Divizionin e Shpërndarjes, pranë Korporatës Elektro-energetike Shqiptare (Sh.a) për të vlerësuar parandalimin dhe ndëshkimin e veprimeve abuzive dhe korruptive nga punonjësit e saj.

1.4 Baza ligjore dhe metodologjia e përdorur në studim

Në kryerjen e studimit dhe të monitorimit të procedimeve dhe vendimeve penale në fushën e veprave penale të korrupsionit janë mbajtur parasysh: konventat e ratifikuara nga Shqipëria në fushën e luftës kundër korrupsionit, legjislacioni penal dhe ai procedural penal shqiptar, si dhe legjislacioni mbi të cilin janë organizuar dhe funksionojnë organet - objekt monitorimi.

Në analizën e gjendjes dhe të tendencave të politikës penale kundër veprave penale të korrupsionit jemi bazuar jo vetëm në të dhënat e mbledhura nga monitorimi i procedimeve penale dhe vendimeve gjyqësore, por edhe nga takimet me prokurorë dhe

⁴ Të gjitha nenet e mësipërme kanë ndryshuar me ligjin 9275, datë 16.09.2004.

⁵ Në studimin e procedimeve penale nuk është bërë objekt studimi marrja e mitës

gjyqtarë të prokurorive dhe gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Vlorë dhe Shkodër si dhe të apelit në rrethet përkatëse.

Disa nga hapat e ndërmarra në përmbushje të objektivave të studimit ishin:

- Analiza e legjislacionit ekzistues në përqasje me standardet ndërkombëtare. Për këtë u angazhuan ekspertë të fushës penale dhe me përvojë akademike.
- Monitorimi i procesit të rregullt ligjor dhe efektivitetit të vendimeve në disa raste të përzgjedhura (prokurori, gjykatë, procedim administrativ), në rrethet Tiranë, Shkodër, Vlorë.
- Monitorimi i procesit të rregullt ligjor në këndvështrimin e barazisë gjinore.
- Diskutimi i produkteve me grupet e interesit.
- Ndërgjegjësimi i publikut përmes aktiviteteve (tryezave, publikimeve, fletëpalosjeve) etj.

Bazuar në gjetjet nga monitorimi, u përgatit ky raport që pasqyron rezultatet e analizës së monitorimit dhe u bë publikimi i tij.

KREU II

PËRQASJA E LEGJSLACIONIT SHQIPTAR ME STANDARTET NDERKOMBËTARE DHE PROBLEMATIKA E ZBATIMIT TË TYRE NË LUFTEN NDAJ KORRUPSIONIT

2.1 Reforma ligjore në fushën penale.

Në kuadrin e masave kundër korrupsionit, përqasja e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare, përbën një nga aspektet më të rëndësishme. Rritja e angazhimeve në nivel ndërkombëtar, solli si pasojë reformën ligjore në fushën e legjislacionit penal me qëllim goditjen e korrupsionit në të gjitha format e tij. Veçanërisht, me mjaft rëndësi paraqiten shtesat dhe ndryshimet e bëra së fundmi në Kodin Penal. Formulimet për korrupsionin tashmë mbështeten kryesisht në aktet juridike ndërkombëtare. Dispozitat janë përmirësuar në drejtim të përmbajtjes, dhe detajimit të tyre, si dhe janë ashpërsuar masat e dënimit. Është përshtatur sistemi i sanksioneve penale, në të cilin përveç dënimit me heqje të lirisë, parashikohet edhe dënimi me gjobë.

Gjithashtu, në funksion të luftës ndaj korrupsionit, rrethi i dispozitave është zgjeruar në përputhje me realitetin ekonomik, politik dhe social, i cili imponon forma të reja të shfaqjes së praktikave korruptive. Kështu, janë përfshirë në Kodin Penal dispozita të reja që lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore ose të të zgjedhurve vendorë, si dhe të korrupsionit aktiv dhe pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë. Gjithashtu, për herë të parë u parashikuan vepra penale kundër korrupsionit në sektorin privat, të cilat nuk parashikoheshin në të kaluarën.

Një risi në Kodin Penal është parashikimi i përgjegjësisë penale jo vetëm për personat që japin dhe marrin ryshfetin, por edhe për atë kategori që premton ose siguron ushtrimin e ndikimit të paligjshëm në vendimmarrjen e funksionarëve publikë. Për sa i përket përgjegjësisë penale, ajo shtrihet jo vetëm tek personat fizikë, por edhe tek personat juridikë.

Pra, në këndvështrimin e një analize teoriko-juridike situata duket pozitive.

2.2 A ka qenë efikase kjo reformë ligjore në goditjen ndaj korrupsionit?

Ndonëse kuadri ligjor është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme, ai nuk ka pasur suksesin e duhur në ndryshimin e realitetit, ne lidhje me parandalimin dhe goditjen e korrupsionit. Shqipëria vazhdon të ketë nivele të larta të korrupsionit, ndonëse ekzistojnë të gjitha mundësitë që të jetë vendi më pak i korruptuar.

Efektet negative të tij janë ende të pranishme në të gjitha sferat e jetës sociale, ekonomike e politike të vendit.

Në aspektin social, shqetësues është perceptimi i qytetarëve për korrupsionin. Shfaqja e praktikave korruptive në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe veprimtarisë shtetërore, bën që qytetaret ta konsiderojnë atë si një fenomen normal. Ai konsiderohet thjesht si një mjet që mundëson zgjidhjen e shpejtë të problemeve të tyre, duke mos e

perceptuar faktin se janë përfshirë edhe vetë në një akt korruptiv. Korrupsioni perceptohet nga qytetaret si një fenomen jetik, i pranishëm në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tyre të përditshme, ku shpeshherë ata vetë bëhen gjenerues dhe nxitës të tij. Nëse ky fenomen shoqërohet edhe nga problemet e burokracisë, paaftësisë profesionale dhe neglizhencës shtetërore, ai përbën shkakun kryesor për humbjen e besimit të qytetarëve ndaj autoritetit shtetëror.

Mjaft negative janë **efektet e tij edhe në zhvillimin e ekonomisë dhe të mekanizmave të tregut**. Praktikë korruptive e veçanërisht vonesat e pajustificuara, zvarritjet burokratike apo privilegjet e padrejta, kanë ndikuar në moszhvillimin normal të konkurrencës së lirë dhe mosgarantimin e mundësive të barabarta për operatorët ekonomikë. Por, efekti kryesor i korrupsionit është gjenerimi prej tij i kundërligjshmërisë, pabarazisë dhe cenimit të të drejtave e lirive themelore të shtetasve.

Ndonëse pjesa më e madhe e qytetarëve kanë qenë viktime të praktikave korruptive, shumë pak prej tyre janë të ndërgjegjësuar për faktin se korrupsioni përbën një veprimtari kriminale me qëllim përfitimi. Të mirat që sigurohen nga veprimet korruptive nuk janë gjë tjetër veçse produkte kriminale. Në praktikën e përditshme po shfaqet fenomeni i rrezikshëm i riciklimit të tyre në forma të ndryshme investimi, në fusha të caktuara të sektorit publik ose privat, ashtu si edhe për produktet që burojnë nga veprimtari të tjera kriminale.

Praktika të tilla korruptive si nepotizmi, pra sigurimi i favorizimeve bazuar në marrëdhëniet familjare apo lidhjet e gjinisë, apo marrëdhëniet e klientelizmit, ku përfitimet sigurohen përkundërt besnikërisë apo përkatësisë politike, janë një fenomen i zakonshëm. Nuk kanë munguar edhe rastet kur favorët dhe privilegjet janë siguruar duke u nisur nga kritere krahinore apo marrëdhënie të miqësisë. Ky aspekt i shfaqjes së korrupsionit e bën atë të dukshëm jo vetëm nga pikëpamja sociale, por edhe ajo politike. (Kjo e fundit, ka edhe aspekte të tjera të ndjeshme korruptive, të cilat nuk janë objekt i studimit tonë).

Në kontekstin e kësaj panorame natyrshëm lind pyetja: Sa efikase kanë qenë masat ligjore antikorruption dhe si mund të përmirësohen ato?

Ndonëse legjislacioni penal është përmirësuar, ndryshimet e shpeshta kanë shkaktuar vështirësi në zbatimin e tij në praktikë. Vështirësi janë hasur veçanërisht në interpretimin e normave ligjore ku vihen re qëndrime të ndryshme të subjekteve procedurale, prokurorisë dhe gjykatës për të njëjtën çështje. Gjithashtu, reforma ligjore nuk mund të jetë e suksesshme pa një përmirësim të praktikave dhe procedurave të hetimit, ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit, si dhe masave të parandalimit të tij.

Roli aktiv i organeve të drejtësisë në zbatimin e legjislacionit, mbetet një nga aspektet më të rëndësishme në luftën ndaj korrupsionit. Në fund të fundit, janë pikërisht këto organe që i japin jetë dhe e bëjnë efikas legjislacionin penal. Roli i prokurorisë në këtë aspekt merr një rëndësi të veçantë për shkak të faktit se shpeshherë në procedimet që lidhen me korrupsionin, provat janë mjaft të vështira për tu siguruar. Kjo vështirësi rritet ndjeshëm në mungesë të një denoncimi të rasteve të korrupsionit nga ana e qytetarëve. Për këtë qëllim, duhet të realizohen trajnime të specializuara për policinë gjyqësore, prokurorët dhe gjyqtarët në lidhje me korrupsionin, teknikat e veçanta hetimore të tij dhe lidhjet e tij me krimet e tjera. Por, një sërë problemesh u evidentuan gjatë monitorimit në këto organe, disa prej të cilave nuk vareshin

nga praktikat e tyre, por nga krijimi i infrastrukturës së nevojshme dhe nga forcimi i bashkëpunimit të këtyre organeve me organe të tjera shtetërore. P.sh., si shqetësim i dukshëm u paraqit pamundësia financiare e organeve të prokurorisë për të përsosur praktikat e saj në ndjekjen penale të këtyre veprave. Ndërkohë, u bë e qartë se, autorët e veprave penale korruptive i përsosin vazhdimisht taktikat dhe mjetet e tyre. Pamundësia financiare u paraqit gjithashtu, si një nga shkaqet kryesore të mungesës së vazhdimësisë së transparencës së gjykatave, përmes publikimeve në faqen e internetit etj. Shqetësime u ngritën edhe lidhur me problemet që krijohen për shkak të mostrajnitit dhe nivelit të ulët profesional të juristëve dhe personave përgjegjës të institucioneve të ndryshme, gjë që dobëson luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e tij nga zyrtarët publikë përkatës.

KREU III

DISA TË DHËNA TË DALA NGA MONITORIMI I PROCEDIMEVE ADMINISTRATIVE NË FUSHËN KUNDER KORRUPSIONIT

3.1 Hyrje

Parandalimi i korrupsionit nuk është detyrë vetëm e organeve të drejtësisë. Para së gjithash, ai kërkon hartimin e politikave dhe ndërtimin e sistemit për mirëfunksionimin e organeve të ndryshme shtetërore dhe private, në mënyrë të tillë që të minimizohet kuptimi dhe zbatimi i ndryshëm dhe pa efikasitet i ligjit, si dhe të mundësohet respektimi i tij në çdo hap të veprimtarisë së tyre.

Masat disiplinore janë një nga mjetet e reagimit të administratës ndaj abuzimeve me detyrën, nga punonjësit e saj. Prandaj, në kuadër të objektivave të studimit, me interes është njohja e zbatimit efikas të masave disiplinore ndaj punonjësve, për shkak të abuzimeve me detyrën. Në morinë e institucioneve të vlerësuara me probleme në fushën e shpërdorimit të detyrës dhe veprimeve korruptive, u përzgjedh Drejtoria Rajonale, Tiranë (ish-Zona e Shpërndarjes Elektrike, Tiranë), në Divizionin e Shpërndarjes, pranë Korporatës Elektro-energjetike Shqiptare Sh.a.

Para së të analizojmë reagimin e këtij institucioni ndaj veprimeve abuzive me detyrën, do të dëshironin të bënim me dije se, në parandalimin dhe ndëshkimin e abuzimeve me detyrën, ky organ procedon në bazë të Kodit të punës, Kodit penal, Kodit të procedurës penale, kontratave kolektive⁶ dhe Udhëzimit të KM, Për zgjidhjen e kontratës së Punës, të datës 27.09.2005. Studimi ynë përfshiu periudhën 2004-2006 dhe synon të sjellë tek lexuesi dhe personat e interesuar një informacion në lidhje me abuzimet më të shpeshta në detyrë, natyrën e tyre dhe mënyrën e reagimit të institucionit ndaj tyre.

3.2 Masat disiplinore të marra nga vetë institucioni ndaj punonjësve

Në varësi të llojit të abuzimit dhe rrezikshmërisë së tij, janë marrë masa të karakterit administrativ të cilat jepen nga titullari i institucionit si: Drejtori i Zonës së Shpërndarjes Elektrike, Tiranë ose institucioni epror, që në rastin në fjalë, është Drejtori i Divizionit të Shpërndarjes pranë Korporatës Elektro-energjetike Shqiptare Sh.a.

Gjatë periudhës 2004 -2007, janë dhënë 165 masa administrative ndaj punonjësve të këtij institucioni të cilët, kanë shpërdoruar detyrën. Nga studimi rezulton se masat administrative janë zbatuar ndaj lexuesve, elektrikistëve dhe inxhinierëve. *Vihet re një rritje e lehtë e numrit të personave të ndëshkuar me masa disiplinore në vite.* Në tërësi, masat

⁶ Për më shumë shih Kontrata kolektive nr. 5024 prot., date 27.06.2002 dhe kontrata kolektive nr. 8734 prot., datë 02.11.2004

janë zbatuar ndaj personelit femra dhe meshkuj, por 65 për qind e personave që janë ndëshkuar kanë qenë meshkuj. Ky tregues nuk mundëson të arrijmë në ndonjë përfundim nëse meshkujt janë më të prirur për të abuzuar me detyrën sesa femrat, por për efekte të studimit gjinor mendojmë se kjo e dhënë mund të jetë në mbështetje të dy hipotezave: ose, numri i personelit meshkuj që janë punësuar në këtë institucion është më i lartë se ai femrave, ose femrat janë më të kujdesshme në përmbushjen me korrektesë të detyrave.

Tabela nr. 1 Masat disiplinore nën vështtrimin gjinor

VITI	Totali	Femra	Meshkuj
2004	42	22	20
2005	49	19	30
2006	57	10	47
2007 ⁷	17	6	11
2004-2007	165	57	108

Kodi i punës nuk parashikon në mënyrë të shprehur masat disiplinore që mund të jepen në raste të abuzimeve me detyrën, të cilat në fakt, parashikohen nga kontrata kolektive e lidhur ndërmjet përfaqësuesve të KESH Sh.a dhe Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë. Duke iu referuar kontratave kolektive të lidhura, rezulton se janë vendosur masa disiplinore të tilla si: vërejtje, kalim në një detyrë të një niveli më të ulët për një periudhë deri në gjashtë muaj, vërejtje me paralajmërim për largim nga puna dhe largim nga puna.

Tabela nr. 2 Llojet e masave të zbatuara ndaj personave që kanë kryer shkelje administrative

Viti	Totali	Vërejtje	Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna	Kalim në një detyrë të një niveli më të ulët	Pushim nga puna
2004	42	13	11	10	8
2005	49	15	13	11	10
2006	57	1	17	14	25
2007 ⁸	17	13	4	-	-
Totali	165	29	41	35	43

Nga analiza e të dhënave të mbledhura që paraqiten në tabelën nr. 2, rezulton se ndaj punonjësve që kanë kryer shkelje janë zbatuar të gjitha llojet e masave disiplinore. Në varësi të llojit të abuzimeve, punëdhënësi ka paraqitur kallëzime penale në organin e

⁷ Masat e shënuara në vitin 2007 janë dhënë nga institucioni epror: Drejtori i Divizionit të Shpërndarjes pranë Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a dhe i përkasin periudhës deri në Maj, 2007

⁸ Të dhënat i përkasin periudhës Janar-Maj 2007

prokurorisë për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. *Vërejtja, si dhe vërejtja me paralajmërim për pushim nga puna, janë masat që janë përdorur më shumë, të pasuara nga masa për pushim nga puna. Largimet nga puna në vitin 2006 janë trefishuar në krahasim me vitin 2004.* Gjithashtu, gjatë vitit 2006, vihet re një rritje e zbatimit të masës kalim në një detyrë të një niveli më të ulët.

Duke pasur parasysh efektin social e psikologjik që krijon pushimi nga puna, si dhe për të shmangur një qëndrim abuziv të punëdhënësit, është e rekomandueshme që kjo masë të jepet nga institucioni, kurse shqyrtimi i ankimeve të punonjësve të bëhet nga një gjykatë administrative. Ne vijmë në këtë përfundim bazuar në faktin se shpesh pushimet nga puna për vepra penale të shpërdorimit të detyrës kanë qenë të diskutueshme dhe të kontestueshme nga punonjësit. Gjithashtu, sipas praktikës së sotme, shqyrtimi i ankimeve në gjykatë për konfliktet e punës zgjat për një periudhë të gjatë, me shumë seanca gjyqësore, të lodhshme dhe jo efektive. Punonjësit, edhe kur fitojnë të drejtën e tyre nuk arrijnë ta rivendosin atë. Është më se i nevojshëm krijimi i gjykatave administrative, pasi ndihmesa që jep avokati i Popullit në këtë drejtim ka rezultuar e pamjaftueshme dhe nuk mund të shtrihet në subjekte private.

Tabela nr. 3 Të dhëna për kallëzimet e bëra në Prokurori gjatë vitit 2007⁹

NR.	Arsimi	Vendbanimi	Gjendja Gjyqësore	Profesioni	Shkaku i Denoncimit
1	8-vjeçar	Tiranë	E padënuar	Faturuese	Shpërdorim detyre
2	8-vjeçar	Tiranë	E padënuar	Faturuese	Shpërdorim detyre
3	8-vjeçar	Tiranë	i padënuar	Elektricitist	Shpërdorim detyre
4	8-vjeçar	Tiranë	E padënuar	Arkëtare	Shpërdorim detyre dhe vjedhje të energjisë

Nga analiza e të dhënave të tabelës së mësipërme, rezulton se, deri në Maj të këtij viti janë bërë 4 kallëzime penale për punonjës të këtij institucioni, kryesisht të nivelit bazë, si arkëtarë/re. Akuza ndaj tyre në të gjitha rastet ka qenë shpërdorim i detyrës dhe në një rast, ajo e vjedhjes së energjisë. Në tre nga këto katër raste të akuzuarat kanë qenë femra.

Krahasuar me problemet që kanë shtetasit në lidhje me faturimet e energjisë elektrike dhe mënyrën e trajtimit të ankesave të tyre nga administrata përkatëse, mendojmë se masat e dhëna janë të pakta dhe nuk i shërbejnë sa duhet parandalimit të abuzimeve në detyrë. Më e rëndësishme, është marrja e masave parandaluese për abuzimet, si përzgjedhja më e mirë e punonjësve gjatë emërimit të tyre; vendosja e kriterëve të vlerësimit të punës së tyre; studimi i opinionit të publikut për shërbimet, për korrektesën e shërbimit të kësaj agjencie, si dhe për korrektesën e punonjësve të saj,

⁹ Në kohën e kryerjes së studimit, për këto denoncime akoma nuk kanë filluar veprimet procedurale sepse sapo ishin dorëzuar në prokurori (rreth 2 javë) .

vendosja e disa treguesve të matjes së performancës së punonjësve bazuar edhe në vlerësimet e shtetasve.

Nga ana tjetër, pa mohuar rolin e masave administrative, me rëndësi është rritja e rolit të gjykatës për zgjidhjen e shpejtë, me procedurë të shkurtuar të konflikteve mes shtetasve dhe punonjësve që abuzojnë. Duke qenë se deri më sot, për abuzimet e punonjësve nuk ka përgjegjës për dëmet që ata i shkaktajnë klientëve që marrin shërbime prej tyre, është e nevojshme të shihet përdorimi më i gjerë i dëmshpërblimeve dhe zbatimi i masave penale ndaj personave që abuzojnë me detyrën, por edhe ndaj shtetasve që vjedhin energjinë¹⁰.

¹⁰ Sipas të dhënave të statistikave zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, për vjedhje të energjisë elektrike ose impulseve të telefonit janë dënuar respektivisht në vitin 2002-163 persona , 2003 – 169 persona, 2004 – 11 persona 2005- 44 persona. Pra, shihet se ka një rënie të numrit të shtetasve të dënuar për vjedhje të energjisë ose impulseve, ndërkohë që dihet dhe është njohur nga administrata e Koorporatës, që numri i personave që nuk paguajnë për energjinë e konsumuar është i lartë.

KREU IV

VËSHTRIM KRIMINOLOGJIK I PROCEDIMEVE PENALE NË FUSHËN KUNDËR KORRUPSIONIT

4.1 Prokuroria-organ i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit

Sipas kodit të Procedurës Penale, prokuroria është organi i ndjekjes penale. Fillimi i procedimit penal për veprat penale të korrupsionit është kompetencë e këtij organi. Suksesi i parandalimit dhe i ndëshkimit të korrupsionit është i lidhur ngushtë me mënyrën e funksionimit dhe efektivitetin e tij. Në analizën e politikës penale të ndjekur nga organi i prokurorisë është me interes të studiohet numri i çështjeve të filluara, të përfunduara dhe mënyra e përfundimit të tyre; politika penale e ndjekur për forma të veçanta të veprës penale, si dhe të shpjegohen, për aq sa është e mundur, efektiviteti i politikës kriminale dhe i organeve që e zbatojnë atë.

Sipas statistikave të Prokurorisë së Përgjithshme, në vitin 2004, në shkallë vendi ishin nisur 433 procedime penale për vepra penale kundër korrupsionit, 262 ndjekje ishin për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, 31 procedime për korrupsion pasiv të funksionarëve të lartë dhe 5 për veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione të larta.

Në vitin 2005 dhe 2006 vihet re një rritje e numrit të procedimeve penale për këto vepra. Sipas statistikave zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme¹¹ rezulton se nga krahasimi i të dhënave të procedimeve penale për periudhën 2005-2006, në fushën e veprave penale kundër korrupsionit¹², gjatë 9 muajorit të parë të vitit 2006 numri i procedimeve penale u rrit në 524 procedime penale, nga 328 të tilla që ishin regjistruar gjatë 9 muajorit të parë të vitit 2005. Gjithashtu është rritur numri i personave të dënuar nga gjykatat në shkallë vendi. Po sipas statistikave zyrtare të këtij organi, procedimet penale për veprat penale të monitoruara në këtë studim, përbëjnë një numër të konsiderueshëm në totalin e procedimeve penale në fushën e veprave të korrupsionit. Në shkallë vendi, gjatë 9 muajorit të parë të vitit 2006 janë regjistruar 524 procedime penale për veprat penale në fushën e korrupsionit, nga të cilat 355 janë procedime penale për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, 25 për veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, 4 për veprën penale të korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë.

Pavarësisht, se në çdo rast Prokuroria disponon të dhëna zyrtare të sakta, është interes analiza e ndjekjes penale për veprat penale kundër korrupsionit, nga këndvështrimi ynë si një organizatë e pavarur, pavarësisht se fusha e monitorimit të saj është e kufizuar.

¹¹ Për më shumë shih <http://www.pp.gov.al/alb/statistike/stat%202006/stat0602.html>

¹² Në këtë grup veprash penale, organi i prokurorisë ka përfshirë 11 vepra penale, nga të cilat 10 të parashikuara nga kodi penal (civil) dhe një nga kodi penal ushtarak. Në to përfshihen përkatësisht nenet: 244, 245, 248, 70 dhe 250, 256, 257, 258, 259, 260, 319, 328.


4.2 Të dhënat e monitorimit të procedimeve penale në prokurorinë e rrethit Tiranë, Vlorë dhe Shkodër

Studimi i procedimeve penale në fushën e korrupsionit në prokuroritë e rretheve të monitoruara tregon se ka një disproporcion të konsiderueshëm mes çështjeve penale të filluara, të përfunduara dhe atyre të dërguara në gjykatë. Duke qenë se monitorimi u mundësua më tepër me detaje pranë prokurorisë së Tiranës e të Vlorës, të cilat kanë numrin më të madh të procedimeve penale për veprat penale objekt monitorimi, në vijim do të analizojmë politikën penale të ndjekur nga këto prokurori, në këtë fushë.

Për periudhën 2004-2006, prokuroria e Tiranës ka nisur 217 procedime penale me 85 të pandehur për veprat penale në fushën e korrupsionit¹³. Pra, numri i procedimeve penale ka ardhur në rritje. Në ndryshim nga Tirana, numri i çështjeve penale të përfunduara nga prokuroria e Vlorës nuk ka të njëjtën tendencë. Në periudhën 2004-2006, prokuroria e Vlorës ka nisur 55 procedime penale dhe në vitin 2006 ka regjistruar një rënie të tyre në krahasim me dy vite më parë, por përsëri ka rritje në 6-mujorin e I-rë të vitit 2007.

Në vitin 2006 procedimet penale të prokurorisë së Tiranës janë rritur dy herë në krahasim me vitin 2004. Jo për të gjitha procedimet penale të filluara, janë marrë të pandehur. Megjithatë, edhe numri i këtyre të fundit, ka ardhur në rritje në vitin 2006. Grafikët e mëposhtëm e tregojnë më mirë këtë tendencë në Prokurorinë e Tiranës që ka edhe numrin më të madh të procedimeve në shkallë vendi.

Grafiku nr. 1 Të dhënat e procedimeve penale të prokurorisë së Tiranës



Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm, numri i çështjeve penale për korrupsion të përfunduara nga prokuroria e Tiranës dhe numri i personave të marrë si të pandehur, ka ardhur në rritje gjatë periudhës 2004-2006. Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e çështjeve penale është dërguar për gjykim. 47.4 për qind e çështjeve penale janë pushuar, ndërsa 28.1 për qind e tyre ishin në hetim në momentin e kryerjes së studimit.

¹³ Fjala është për veprat penale të përmendura si objekt monitorimi në këtë studim dhe jo për të gjitha veprat penale në fushën e korrupsionit.


Në interes të studimit dhe vlerësimit të politikës kriminale është analiza e procedimeve sipas llojit të veprës penale.

Tabela nr. 4 Të dhënat në lidhje me çështjet penale dhe numrin e të pandehurve sipas veprave penale të proceduara në Tiranë

Akuza	Neni 248		Neni 250		Neni 259		Neni 260	
Viti	çështje	pandehur	çështje	pandehur	Çështje	pandehur	çështje	Pandehur
2004	42	14	8	6	3	1	6	7
2005	36	12	11	3	5	4	1	-
2006	81	28	10	2	13	7	1	1
Total	159	54	29	11	21	12	8	8

Të dhënat e tabelës së mësipërme pasqyrohen në mënyrë më qartë në grafikun e mëposhtëm .

Grafiku nr. 2 Procedimet penale të prokurorisë së Tiranës sipas veprave penale të monitoruara



Nga tabela dhe grafiku i mësipërm del e qartë se gjatë periudhës 2004-2006, procedimet penale të përfunduara nga prokuroria e Tiranës për veprën penale të shpërdorimit të detyrës zënë vendin e parë në grupin e veprave penale të korrupsionit, të pasuara nga vepra penale kryerja e veprimeve arbitrare (neni 250 i k.p), e cila megjithatë, nuk konsiderohet të jetë e lidhur në çdo rast me korrupsionin. Në vitin 2006, krahasuar me vitin 2004, ka dy herë më shumë procedime penale të përfunduara për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

Numri i procedimeve penale, për veprën penale korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259 i k.p) dhe korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë (neni 260 i k.p) është i pakët në numër, krahasuar me procedimet

penale për shpërdorim detyrë. Nga të dhënat e mbledhura rezulton se numri i personave të marrë si të pandehur është i ulët, jo vetëm në krahasim me veprat e tjera penale të së njëjtës fushë, por edhe me numrin e procedimeve për këtë vepër penale.

Arsyet e kësaj gjendjeje mund të jenë të karakterit objektiv dhe subjektiv. Sipas mendimit tonë, numri i ulët i procedimeve penale ka lidhje me shkallën e ulët të raportimit të rasteve të tilla, si dhe me vështirësitë e provueshmërisë së tyre. Ndonëse këto vepra penale janë të përhapura në vendin tonë dhe rregullimi i tyre është bërë sipas rekomandimeve të Rezolutës 97.24 të Këshillit të Evropës, zbatimi i kësaj dispozite në praktikë kërkon para së gjithash, një sensibilizim dhe informim të publikut për format, kuptimin e korrupsionit pasiv dhe format e shfaqjes së tij në marrëdhënien e shtetasve me funksionarët dhe të zgjedhurit vendorë. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë veçanërisht juristët pranë institucioneve, të cilët shpesh janë pa përvojën e duhur në këtë fushë e madje, në mjaft raste porsa kanë përfunduar studimet. Kjo ka sjellë probleme në kallëzimet e denoncimet pranë prokurorisë, jo vetëm për shkak të njohjes së pakët të ligjit material e procedural penal, por edhe për servirjen e provave. (Këtu, nuk është marrë parasysh fakti kur juristi vepron sipas urdhërimeve të titullarëve të institucionit, pavarësisht se është i bindur në mungesën e elementeve të figurës së veprës penale).

Nga ana tjetër, kodi Penal ka pësuar ndryshime në vitin 2004. Zgjerimi i nocionit të korrupsionit aktiv dhe pasiv kërkon edhe një praktikë gjyqësore, e cila ende nuk është krijuar. Trajnimi vazhdues i oficerëve të policisë gjyqësore, prokurorëve dhe gjyqtarëve është i nevojshëm. Në këtë drejtim, është e nevojshme të rritet edhe atë çfarë përcaktohet në nenin 6 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, të ratifikuar edhe nga Shqipëria në vitin 2006 sipas të cilit, secili shtet palë duhet të rrisë dhe të shpërndajë njohuri rreth parandalimit të korrupsionit¹⁴.


4.3 Mënyra e përfundimit të procedimeve penale

Sipas Kodit të procedurës penale, procedimi penal mund të përfundojë në disa mënyra, të cilat varen nga analiza e një sërë faktorëve. Megjithatë, njohja e raportit mes procedimeve të filluara dhe çështjeve të dërguara në gjykatë, tregon për efektivitetin e funksionit të hallkave të sistemit të luftës kundër korrupsionit si: efikasiteti i ligjit dhe i përmbajtjes së tij, cilësia e materialit denoncues, efektiviteti i organit të prokurorisë dhe aftësia provuese e tij, krijimi i infrastrukturës efikase (mjeteve) për ndjekjen penale nga ana e Prokurorisë, si dhe koordinimi mes institucioneve të ndryshme të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet mënyra e përfundimit të procedimeve penale nga ana e prokurorisë së Tiranës.

¹⁴ Konventa është miratuar me ligjin 9492, datë 13.03.2006: Për Ratifikimin e Konventës së kombeve të bashkuara kundër korrupsionit.

Grafiku nr. 3 Të dhënat për mënyrën e përfundimit të procedimeve penale nga prokuroria e Tiranës për periudhën 2004-2006



Grafiku i mësipërm tregon qartë se, rreth 50 për qind e procedimeve penale të filluara nga prokuroria e Tiranës janë pushuar, 28 për qind e procedimeve penale ishin në hetim gjatë kohës së zhvillimit të monitorimit dhe 17.5 për qind e tyre ishin dërguar për gjykim.

Nga këndvështrimi i një vëzhguesi të jashtëm është vështirë të shpjegohet se, cilat janë arsyet e kësaj gjendjeje. Nga takimet me përfaqësues të prokurorisë së rretheve përkatëse, është ngritur shqetësimi se në shumë raste, kallëzimet penale nuk përmbajnë elementët e një veprë penale, por që mund të jete një shkelje administrative, ose kallëzimet nuk janë të shoqëruara me dokumente provuese ose, nuk përmbajnë të dhëna që të mund provojnë ekzistencën e veprës penale. Nga ana tjetër, hetimi i veprave të tilla kërkon një njohje të mirë të ligjeve dhe të akteve nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e organeve të ndryshme shtetërore.


Mënyra e përfundimit të çështjeve penale sipas llojit të akuzave të ngritura nga prokuroria Tiranë, ndryshon për vepra penale të ndryshme. Procedimet penale për veprime arbitrare në shumicën e rasteve janë pushuar. Në vitin 2006, në krahasim me periudhën 2004-2005 është rritur numri i pushimit të procedimeve penale dhe çështjeve të dërguara për gjykim për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

Tabela e mëposhtme paraqet një tablo më të qartë për mënyrën e përfundimit të çështjeve penale.

Tabela nr. 5 Mënyra e përfundimit të çështjeve penale sipas llojit të akuzave të ngritura nga prokuroria e Tiranës

Viti	2004					2005					2006				
Kodi Penal (Neni)	Dërguar për gjykim	Pushim	Pezullim	Kompet	Në hetim	Dërguar për gjykim	Pushim	Pezullim	Kompet.	Në hetim	Dërguar për gjykim	Pushim	Pezullim	Kompet.	Në hetim
248	6	17	2	4	13	3	8	1	1	23	15	47	2	1	16
250	-	6	-	-	2	2	8	1	-	1	1	6	3	-	-
259	-	1	-	-	2	3	2	-	-	-	4	5	-	1	3
260	3	2	-	-	1	-	1	-	-	-	1	-	-	-	-
Total	9	26	2	4	18	8	19	2	1	24	21	58	5	2	19

Grafiku nr. 4 Në mënyrë grafike të dhënat e kësaj tabelë paraqiten si më poshtë




Përsa i përket mënyrës së përfundimit të procedimeve penale, një tendencë e tillë, por më e theksuar, vihet re edhe në prokurorinë e Vlorës. Nga të dhënat e analizuar dhe të paraqitura në tabelën nr. 6 dhe grafikun nr. 5 del se në shumicën e rasteve, prokuroria e Vlorës ka vendosur mosfillimin e çështjeve penale për veprat penale të korrupsionit ose, nëse e ka filluar procedimin në disa raste e ka pushuar atë. Numri i mosfillimeve dhe i pushimeve të procedimeve penale është 5.3 herë më i lartë, sesa numri i çështjeve penale të dërguara në gjykatë gjatë periudhës 2004-2006.

Nga 55 procedime penale për periudhën 2004- 2006, vetëm 14.5 për qind e tyre janë dërguar për gjykim. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm e paraqesim më mirë këtë përfundim.

Tabela nr 6 Mënyra e përfundimit të procedimeve penale sipas veprave penale nga prokuroria e Vlorës

Vitet	Pushuar	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Transferuar	Në hetim
2004	3	9	5	-	-
2005	6	14	1	1	-
2006	6	5	2	2	1
Total	15	28	8	3	1

Grafiku nr. 5 Mënyra e përfundimit të procedimeve penale sipas veprave penale nga prokuroria e Vlorës të paraqitura në mënyrë grafike



Bazuar në të dhënat e mësipërme arrijmë në përfundim se, megjithë ndryshimet e bëra në legjislacionin penal lidhur me veprat penale të korrupsionit, zbatimi i tyre në praktikë has vështirësi. Hartimi i qartë dhe i saktë i dispozitave ¹⁵ do të bënte të mundur dallimin më të mirë mes shkeljeve administrative dhe veprimeve që përmbajnë elemente të veprës penale. Zhvillimi i praktikës gjyqësore dhe trajnimi i personelit të seksioneve të krimit ekonomik janë një domosdoshmëri. Është e nevojshme rritja e cilësisë së kallëzimeve penale që vijnë nga institucionet dhe koordinimi mes institucioneve dhe prokurorisë.

Për parandalimin dhe hetimin me efektivitet të veprave penale kundër korrupsionit, e rëndësishme është ekzistenca e procedurave të qarta për kryerjen e funksioneve të ndryshme nga funksionarë publikë dhe të zgjedhur vendorë me qëllim që të shmangen

¹⁵ Sipas Prof.dr. Ismet Elezit, ndryshimi që i është bërë përmbajtjes së nenit 248 të kodit penal (shpërdorimi i detyrës) duke hequr termin "pasoja të rënda" dhe duke e zëvendësuar atë me termin "dëmtim të interesave të ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë", mund të çojë në interpretime subjektive të ligjit. Për më shumë shih: "E drejta penale", pjesa e posaçme, tekst për studentët e fakultetit të drejtësisë, P.S.H, Tiranë, 2005, f. 423.

abuzimet dhe, ligji të kuptohet e të zbatohet në mënyrë të njëjtë, me korrektesë nga të gjithë. Forcimi i kontrollit (auditit) të brendshëm është i nevojshëm. Informimi dhe trajnimi i personave që administrojnë vlera materiale dhe financiare rreth procedurave të prokurimeve dhe tenderimeve, si dhe qartësimi i procedurave për to, do të ndikojë pozitivisht në zbatimin e drejtë të ligjit.

Analiza e problemeve dhe mangësive që vihen re në hetimin dhe gjykimin e veprave penale në fushën e korrupsionit nga punonjës të teorisë dhe të praktikës do të ndikojë në përmirësimin e praktikës, sqarimin e kuptimeve jo të qarta të përmbajtjes së disa neneve të Kodit penal dhe ligjeve të tjera penale të miratuara, kohët e fundit në këtë fushë¹⁶. Qartësimi dhe thjeshtëzimi i dispozitave ligjore ka impakt të drejtpërdrejtë në interpretimin e tyre. Ndryshimet e shumta në legjislacionin penal, hera-herës të pakonsultuara më parë me punonjës të praktikës, përkthimi në mënyrë mekanike dhe të paqartë i dispozitave të konventave ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit, është një arsye tjetër që ndikon jo pak, në uljen e efektivitetit të parandalimit dhe dënimit të veprave penale në këtë fushë.

¹⁶ Nga diskutimet në tryezat e organizuara me gjyqtarë, prokurorë e profesionistë të sistemit të drejtësisë, u ngrit shqetësimi se përmbajtja e disa neneve përkatëse në Kodin penal është e paqartë dhe e ndërlikuar, duke lënë shkas për interpretime subjektive jokorrekte. Si i tillë u vlerësua veçanërisht neni 245/1 i Kodit Penal.

KREU V

VËSHTRIM PRAKTIK I MONITORIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE TIRANË, SHKODËR DHE VLORË

5.1 Veprat penale të korrupsionit dhe gjykatat shqiptare

Funksionimi i sistemit gjyqësor dhe efektiviteti i tij ndikojnë në rritjen e besimit të publikut tek drejtësia. Gjykatat shqiptare, si pjesë e sistemit, luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe ndëshkimit e korrupsionit. Nga ana tjetër, deri diku ato janë edhe pasqyra e efektivitetit të organeve të drejtësisë dhe organeve të tjera shtetërore në parandalimin dhe dënimin e korrupsionit në Shqipëri.

Veprat penale në fushën e korrupsionit kanë qenë objekt gjykimi në gjykatat shqiptare. Sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, gjatë periudhës 2004-2005 numri i çështjeve penale për veprat penale në fushën e korrupsionit është i ulët. Kështu, në shkallë vendi në këtë periudhë, janë gjykuar 110 çështje penale dhe janë dënuar 106 persona. Numri i çështjeve të gjykuara dhe i të dënuarve është rritur në vitin 2005 në krahasim me vitin 2004, megjithatë ato vazhdojnë të jenë në nivele të ulta. Numri i çështjeve penale të gjykuara për veprime arbitrare, kërkim dhe marrje mite, është i ulët¹⁷.

Pavarësisht nga statistikat zyrtare, sikurse është theksuar edhe më lart, me interes është studimi i praktikës së këtyre gjykatave në këtë fushë.

5.2 Veprat penale të korrupsionit të gjykuara në gjykatat objekt -monitorimi

Të dhënat në tabelën e mëposhtme paraqesin një tablo të përgjithshme të çështjeve penale të korrupsionit të gjykuara sipas rretheve dhe, dinamikën e tyre në vite.


Tabela nr 7 Çështjet penale të korrupsionit të gjykuara dhe numri i të gjykuarve sipas rretheve

Viti	Nr. Çështjeve			Nr. Gjykuarve		
	Tiranë	Vlorë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Shkodër
2004	29	5	4	48	6	4
2005	24	8	4	35	10	8
2006	18	5	6	21	5	10
Total	71	18	14	104	21	22


¹⁷ Për më shumë shih "Buletini statistikor 2004", botim i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë 2005, f. 20-21 dhe vjetari statistikor 2005", botim i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë 2006, f. 28. Në këto vjetar ende përdoren termat "kërkim për marrje mite" dhe "marrja e mitës", ndonëse këto dispozita kanë ndryshuar në shtator të vitit 2004.

Analiza e çështjeve penale të gjykuara në gjykatat e rretheve gjyqësore të monitoruara (Tiranë, Vlorë, Shkodër) tregon se gjatë periudhës 2004-2006 janë gjykuar 103 çështje penale të korrupsionit me 147 persona të gjykuar. Numri më i madh i çështjeve penale dhe personave të gjykuar i përket Tiranës, pasuar nga Vlora. Çështjet penale të gjykuara nga gjykata e rrethit Vlorë dhe Shkodër janë të pakta. Në vitin 2006, në tërësi, vihet re një rënie e numrit të çështjeve dhe personave të gjykuar, në krahasim me vitin 2004 dhe 2005.

Grafiku nr. 6 Çështjet penale të korrupsionit dhe numri i të gjykuarve në Tiranë



Grafiku nr. 7 Çështjet penale të korrupsionit dhe numri i të gjykuarve në Vlorë



Numri i çështjeve penale dhe i personave të gjykuar nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, ka ardhur në rënie. Përsa i përket kësaj çështjeje, analiza e të dhënave tregon se numri i çështjeve të gjykuara në gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë, ka një tendencë jo të rregullt. Gjatë vitit 2005 ka një rritje të lehtë të çështjeve dhe personave të gjykuar, ndërkohë që gjatë vitit 2006, ato zbresin në nivelet e vitit 2005.

5.3 Disa karakteristika social-demografike të të gjykuarve për veprat penale të korrupsionit

Megjithëse veprat penale të korrupsionit kanë subjekte të posaçme, me interes kriminologjik, për hartimin e politikave penale efikase, ka rëndësi njohja e disa karakteristikave të personave të gjykuar për veprat penale-objekt monitorimi.

5.3.1 Personat e gjykuar për vepra penale të korrupsionit sipas gjinisë


Sikurse është thënë edhe në pjesën e objektivave të studimit, aspekti gjinor është parë për aq sa është i mundur, pa dashur të paragjykojmë kategorinë meshkuj në këtë studim.

Tabela nr. 8 Gjinia e të gjykuarve për veprat penale –objekt monitorimi


Viti	Të gjykuar			Femra			Meshkuj		
	Tiranë	Vlorë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Shkodër
2004	48	6	4	13	-	1	35	6	3
2005	35	10	8	14	2	-	21	8	8
2006	21	5	10	5	2	1	16	3	9
Total	104	21	22	32	4	2	72	17	20

Të dhënat e mësipërme, paraqiten grafikisht në vijim:


Grafiku 8 Gjinia e të gjykuarve për veprat penale –objekt monitorimi të paraqitura në mënyrë grafike



Tiranë



Vlorë



Shkodër

Gjatë periudhës 2004-2006, nga 147 persona të gjykuar nga të tria gjykatat objekt monitorimi, 38 persona janë femra, ndërsa 74.1 për qind e të gjykuarve janë meshkuj. Numri më i madh i femrave dhe i meshkujve janë gjykuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, Tiranë, e cila ka edhe nr. më të madh të çështjeve të gjykuara. Kryerja e veprave penale më shumë nga meshkujt sesa nga femrat mund të shpjegohet me tendencat e përgjithshme të kriminalitetit në Shqipëri dhe në botë si fenomen me tepër “mashkullor” sesa femëror. Nga ana tjetër, megjithë përpjekjet e bëra për emancipimin e shoqërisë shqiptare, ajo vazhdon të jetë një shoqëri ku barazia gjinore nuk është ende realitet në praktikë. Në shumicën e vendeve drejtuese në administratë, stafi është përbërë nga meshkuj. Një argument tjetër, ndonëse jo shkencor, por i vërtetuar në praktikë është se femrat janë më të kujdesshme në zbatimin e ligjit.

Numri i femrave të gjykuara është i ndryshëm në gjykatat e monitoruara. Numri më i madh i tyre është gjykuar nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë. Nga 104 të gjykuar, 32 ose 30.8 për qind të të gjykuarve janë femra, ndërsa në Vlorë, femrat e gjykuara përbëjnë 19 për qind të të gjykuarve për veprat penale të studiuara dhe në Shkodër, të gjykuarat femra përbëjnë 9.9 për qind të të gjykuarve.

5.3.2 Personat e gjykuar sipas grupmoshave

Analiza e të dhënave të dala nga monitorimi i vendimeve gjyqësore tregon se personat e grupmoshave 36-55 vjeç përbëjnë numrin më të madh të personave të gjykuar për veprat penale të korrupsionit. Nuk ka pasur asnjë person të gjykuar të grupmoshës 18-25 vjeç. 20.4 për qind e të gjykuarve i përkasin grupmoshës 26-35 vjeç.

Më poshtë paraqiten të dhënat për personat e gjykuar sipas gjykatave të rretheve të monitoruara.

Tabela nr. 9 Të gjykuarit për veprat penale të gjykuara nga gjykata e Tiranës

Viti	Gjykuar	18-25	26-35	36-45	46-55	55 e lartë
2004	48	-	8	15	14	9
2005	35	-	7	16	12	1
2006	21	-	5	4	12	-
Total	104	-	20	35	38	10

Grafiku nr. 9 Të gjykuarit sipas moshës, të gjykuar nga gjykata e Tiranës




Tabela nr. 10 Të gjykuarit sipas moshës, të gjykuar nga gjykata e Vlorës

Viti	Pandehur	18-25	26-35	36-45	46-55	55 e lartë
2004	6	-	1	1	4	-
2005	10	-	-	6	4	-
2006	5	-	2	1	2	-
Total	21	-	3	8	10	-

Të dhënat e mësipërme, paraqiten grafiksht në vijim (grafiku 10);

Grafiku nr. 10 Të gjykuarit sipas moshës, të gjykuar nga gjykata e Vlorës





Tabela nr. 11 Të gjykuarit sipas moshës, të gjykuar nga gjykata e Shkodrës

Viti	gjykuar	18-25	26-35	36-45	46-55	55 e lartë
2004	4	-	-	2	-	2
2005	8	-	-	5	2	1
2006	10	-	2	5	2	1
Total	22	-	2	12	4	4

Të dhënat e mësipërme, paraqiten grafiksht në vijim

Grafiku nr. 11 Të gjykuarit sipas moshës, të gjykuar nga gjykata e Shkodrës



Krahasimi i të dhënave të paraqitura në tabelat dhe grafikët e mësipërm tregon se në rrethin e Shkodrës, numri më i madh i të gjykuarve i përket grupmoshës 36-45 vjeç. Përfshirja më e madhe e moshave 36-45 dhe 45-55 vjeç mund të këtë shpjegime të ndryshme si: punësimi më i madh i kësaj grupmoshe në vende drejtuese ose në administratë publike. Megjithatë, vihet re një rritje e numrit të personave të gjykuar që i përket grupmoshës 26-35 vjeç.

5.3.3 Arsimitimi i të gjykuarave për veprat penale të korrupsionit

Veprat penale në fushën e korrupsionit kanë subjekt të posaçëm, të cilët kanë një funksion ose detyrë të caktuar dhe për të cilën kërkohet një nivel arsimor i caktuar.

Tabela nr. 12 Arsimitimi i të gjykuarve në gjykatat e monitoruara

Viti	Tiranë				Vlorë				Shkodër			
	Gjykuar	8 Vjeçar	I mesëm	I lartë	Gjykuar	8 vjeçar	I mesëm	I lartë	Gjykuar	8 vjeçar	I mesëm	I Lartë
2004	48	-	17	31	6	-	6	-	4	-	1	3
2005	35	1	18	16	10	-	7	3	8	-	3	5
2006	21	-	8	13	5	-	1	4	10	-	8	2
Total	104	1	43	60	21	-	14	7	22	-	12	10

Në Tiranë, në krahasim me rrethet e tjera, numri më i madh e të gjykuarve janë me arsim të lartë. Ata përbëjnë 57.7 për qind, në krahasim me të gjykuarit e niveleve të tjera

arsimore. Kjo shpjegohet me faktin që, në Tiranë janë përqendruar institucionet më të rëndësishme dhe më të mëdha të administratës publike. Në rrethin e Vlorës dhe të Shkodrës pjesa më e madhe e të gjykuarave janë me arsim të mesëm.

5.3.4 Vendbanimi i personave të gjykuar


Veprat penale kundër korrupsionit janë kryesisht, vepra penale më të përhapura në zonat urbane, sesa në ato rurale. Pavarësisht nga ky fakt, ka rëndësi të bëhet një vështrim i personave të gjykuar për veprat penale të korrupsionit.

Tabela nr. 13 Të gjykuarit sipas vendbanimit të tyre


	Tirana			Vlora			Shkodra		
Viti	Gjykuar	Qytet	Fshat	Gjykuar	Qytet	Fshat	Gjykuar	Qytet	Fshat
2004	48	43	5	6	4	2	4	4	-
2005	35	33	2	10	10	-	8	8	-
2006	21	18	3	5	3	2	10	8	2
Total	104	94	10	21	17	4	22	20	2

Të dhënat e mësipërme, paraqiten grafikisht në vijim.


Grafiku nr. 12 Të gjykuarit sipas vendbanimit të gjykuar nga gjykata e Tiranës



Grafiku nr. 13 Të gjykuarit sipas vendbanimit të gjykuar nga gjykata e Vlorës



Grafiku nr. 14 Të gjykuarit sipas vendbanimit të gjykuar nga gjykata e Shkodrës



Siç shihet qartë edhe nga tabela dhe grafikët më sipër, shumica e të gjykuarve janë me vendbanim me qytet. Kjo situatë shpjegohet me faktin se për shkak të zhvillimeve pas viteve '90, institucionet kryesore të administratës publike dhe shtetërore janë përqendruar në qytetet kryesore, sidomos në Tiranë. Ndonëse edhe në komuna ka të zgjedhur vendorë dhe subjekte të cilët mund të jenë subjekt i veprave penale të korrupsionit, ata janë më të pakët, në krahasim me ata që ushtrojnë funksione dhe detyra drejtuese në Tiranë. Gjithashtu, fondet që menaxhohen në institucionet qendrore dhe në prokurimet, janë më të shumta në qytet.

5.3.5 Profesioni i personave të gjykuar dhe institucionet ku punojnë

Veprat penale të korrupsionit kanë si subjekt persona të posaçëm. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, jep kuptimin e nocionit *nëpunës publik* ndërsa teoria e së drejtës penale, përcakton kategori të ndryshme të personave që ushtrojnë funksione të larta shtetërore, publike etj.

Të dhënat e dala nga studimi i vendimeve gjyqësore dhe i të gjykuarve sipas rretheve i paraqesim si më poshtë:

Tabela nr. 14 Të gjykuarit sipas profesionit dhe vendit të punës së gjykuar nga gjykata e Tiranës

Viti	Gjykuarve	Profesioni					Vendi i punës						
		Ekonomist	Jurist	Punonjës Policie	Punonjës Kesh	Prof. të tjera	KESH	Polici	Dogana	Tatime	Privat	Inst. të Larta	Të tjera
2004	48	-	2	12	7	27	7	12	-	-	3	6	20
2005	35	10	4	6	7	8	7	6	-	-	1	1	20
2006	21	1	2	7	2	9	2	8	-	-	2	-	9
Total	104	11	8	25	16	44	16	26	-	-	6	7	49

Tabela nr. 15

Të gjykuarit sipas profesionit dhe vendit të punës, të gjykuar nga gjykata e Vlorës

Viti	Gjykuar	Profesioni					Vendi i punës						
		Ekonomist	Jurist	Polic	Faturist Kesh	Prof. të tjera	Punonjës KESH	Punonjës Polici	Dogana	Tatime	Privat	Inst. të Larta	Të tjera
2004	6	-	-	6	-	-	-	6	-	-	-	-	-
2005	10	-	-	8	-	2	-	8	-	-	-	1	1
2006	5	1	2	-	-	2	-	-	-	1	-	2	2
Total	21	1	2	14	-	4	-	14	-	1	-	3	3

Tabela nr. 16

Të gjykuarit sipas profesionit dhe vendit të punës, të gjykuar nga gjykata e Shkodrës

Viti	Gjykuar	Profesioni					Vendi i punës						
		Ekonomist	Jurist	Polic	Faturist Kesh	Prof. të tjera	Punonjës KESH	Punonjës Polici	Dogana	Tatime	Privat	Inst. të Larta	Të tjera
2004	4	-	-	3	-	1	-	3	-	-	1	-	-
2005	8	-	-	4	-	4	-	4	-	-	4	-	-
2006	10	-	-	4	-	6	-	4	-	-	-	-	6
Total	22	-	-	11	-	11	-	11	-	-	5	-	6

Nga të dhënat rezulton se pjesa më e madhe e të gjykuarve në Tiranë janë me profesion punonjës policie dhe punonjës në KESH, të pasuar nga persona me profesion ekonomist. Profesionin e tyre ka lidhje edhe me vendin e punës. Për rrjedhojë është e natyrshme që ata të punojnë në polici dhe në KESH.

Në krahasim me rrethin e Tiranës, në Vlorë dhe në Shkodër pjesën më të madhe të të gjykuarve e zënë punonjësit e policisë. Gjithashtu, në Tiranë dhe në Shkodër ka edhe të gjykuar që janë punonjës të subjekteve private. *Gjatë kësaj periudhe, bie në sy fakti se, nuk është gjykuar asnjë punonjës i zyrës së tatimeve dhe doganave, ndërkohë që sipas sondazheve të matjes së perceptimit publik për korrupsionin, rezulton që doganat dhe tatimet të jenë ndër sektorët e korruptuar në Shqipëri.*

5.3.6 Disa të dhëna në lidhje me akuzën dhe llojin e dënimit në gjykatat e monitoruara

Kodi penal parashikon lloje dhe masa të ndryshme dënimi për veprat penale të korrupsionit, bazuar në përhapjen e këtij kriminaliteti dhe në dëmin që i shkakton ai, stabilitetit dhe sigurisë së vendit, demokracisë dhe vlerave të institucioneve, lidhjeve që mund të ketë korrupsioni me format e tjera të krimit. Lloji dhe masa e dënimit është ashpërsuar. Kështu, krahas dënimit me burgim zbatohen edhe dënimi me gjobë dhe minimumi i dënimit me burgim, është rritur.

Me interes është të analizohet politika e dënimit për veprave penale të monitoruara.

Tabela nr. 17 Numri i të gjykuarve sipas akuzave

Lloji i veprës penale	Tirana				Vlora				Shkodra			
	Gjykuar			Totali	Gjykuar			Totali	Gjykuar			Totali
	2004	2005	2006		2004	2005	2006		2004	2005	2006	
Shpërdorim detyre (248 i k.p)	43	27	12	82	6	10	4	20	4	8	10	22
Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (259 i k.p)	-	6	3	9	-	-	1	1	-	-	-	-
Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendore (260 i k.p)	-	1	2	3	-	-	-	-	-	-	-	-
Marrja e mitës (206 i k.p)	3	1	1	5	-	-	-	-	-	-	-	-
Kryerja e veprimeve arbitrare (250 i k.p)	4	-	1	5	-	-	-	-	-	-	-	-
Total	50	35	19	104	6	10	5	21	4	8	10	22

Siç shihet nga tabela e mësipërme, në të tre gjykatat objekt monitorimi, të gjykuarit për shpërdorim detyre (neni 248 i kodit penal) zënë një përqindje të lartë në krahasim me llojet e tjera të akuzës.

5.3.7 Dënimi dhe zbatimi i tij ndaj personave që kanë kryer vepër penale të korrupsionit

Kodi penal i vitit 1995, i ndryshuar në 2001 dhe 2004 parashikon dënimin me burgim dhe njëkohësisht me gjobë, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Përsa i përket korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike (259 i k. p) dhe

korupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë (260 i k. p), ligji parashikon dënime të ashpra me burgim dhe me gjobë, njëkohësisht¹⁸.

Më poshtë po paraqesim politikën e dënimit të zbatuar nga secila gjykata e monitoruar.

Tabela nr. 18 Llojet e dënimeve të zbatuara nga gjykata e Tiranës

Viti	Burg	Kusht	Gjobe	Pafajësi	Kthim	Pushim
2004	4	6	14	23	3	-
2005	9	8	15	4	-	1
2006	8	7	15	3	-	-
Total	21	21	44	30	3	1

Tabela nr. 19 Llojet e dënimeve të zbatuara nga gjykata e Vlorës

Viti	Burg	Kusht	Gjobe	Pafajësi	Kthim	Pushim
2004	-	-	4	-	1	1
2005	1	-	7	1	-	1
2006	2	1	3	2	-	-
Total	3	1	14	3	1	2

Tabela nr. 20 Llojet e dënimeve të zbatuara nga gjykata e Shkodrës

Viti	Burg	Kusht	Gjobe	Pafajësi	Kthim	Pushim
2004	1	-	1	2	-	-
2005	3	-	1	-	1	3
2006	2	-	5	3	-	-
Total	6	-	7	5	1	3

Siç rezulton nga të dhënat e studiuara, të tre gjykatat e monitoruara kanë zbatuar dënimin me burgim dhe me gjobë. Gjykata e Tiranës ka aplikuar edhe dënimin me kusht.

¹⁸ Në interpretimin e të dhënave që përmbajnë tabelat duhet bërë kujdes pasi totali i dënimeve të aplikuara nuk është i njëjtë me numrin e personave të dënuar, pasi siç është thënë edhe më lart, ligji penal parashikon zbatimin e dy dënimeve për një person që kryen një vepër penale.

Rastet e dhënies së pafajësisë janë të larta në gjykatën e Tiranës. Krahësuar me numrin e të gjykuarve, edhe në rrethë numri i pafajësive është gjithashtu i lartë. *Dhënia e pafajësisë në një numër të madh rastesh tregon se, hetimi i çështjeve penale për veprat e korrupsionit është problematik dhe se është e nevojshme rritja e cilësisë së hetimeve dhe e provueshmërisë nga ana e organit të prokurorisë.*

5.4 Statusi i personave të gjykuar

Për shkak të rrezikshmërisë së veprave penale të korrupsionit, organi i prokurorisë ka të drejtë të zbatojë masa të sigurimit personal ndaj personave që akuzohen për vepra të tilla. Në kërkesën e masës së sigurimit nga ana e prokurorisë dhe në vlerësimin që gjykata u bën këtyre masave, mbahen parasysh kriteret e përcaktuara në Kodin e procedurës penale.

Nga të dhënat e mbledhura rezulton se, në të tria gjykatat, 82.7 për qind e të gjykuarve kanë qenë prezent në gjykim dhe pjesa tjetër është gjykuar në mungesë. 18.3 për qind e të akuzuarve kanë qenë në arrest dhe 77.9 për qind, janë gjykuar në gjendje të lirë.

Në vitet 2005-2006 ka një rritje të lehtë të numrit të të gjykuarve në gjendje arresti. Arsyet mund të jenë të ndryshme si: rritja e rasteve të denoncimeve për veprat penale të korrupsionit, ndryshimet e Kodit Penal në lidhje me veprat korruptive të kryera në vitin 2004 dhe forcimi i luftës kundër korrupsionit, i cili është një prioritet i qeverisë dhe i organeve të drejtësisë. Personat e gjykuar në Shkodër janë gjykuar të gjithë në gjendje të lirë.

Më poshtë, po paraqesim të dhënat për statusin e të gjykuarve sipas gjykatave të monitoruara.

Tabela nr. 21 Të dhënat në lidhje me *statusin* e të gjykuarve në Tiranë

Viti	Gjykuar	Prezent	Mungesë	Arrest	I Lirë
2004	48	45	3	4	44
2005	35	30	5	8	25
2006	21	11	10	7	12
Total	104	86	18	19	81

Tabela nr. 22 Të dhënat në lidhje me *statusin* e të gjykuarve në Vlorë

Viti	Gjykuar	Prezent	Mungesë	Arrest	I Lirë
2004	6	6	-	-	6
2005	10	8	2	1	9
2006	5	5	-	1	3
Total	21	19	2	2	18

Tabela nr. 23

Të dhënat në lidhje me *statusin* e të gjykuarve në Shkodër

Viti	Gjykuar	Prezent	Mungesë	Arrest	I Lirë
2004	4	4	-	-	4
2005	8	8	-	-	8
2006	10	10	-	-	10
Total	22	22	-	-	22

5.5 Ankimimi kundër vendimeve gjyqësore në fushën e veprave penale të korrupsionit

Ankimi kundër një vendimi gjyqësor është e drejtë kushtetuese, e cila ushtrohet gjerësisht nga personat e akuzuar për kryerjen e një veprë penale, por edhe nga organi i akuzës. Me interes është njohja e ecursionit të procedimeve penale për veprat penale të korrupsionit, pas ankimit të vendimeve të dhëna. Duke qenë se Tirana, ka edhe numrin më të madh të vendimeve gjyqësore, po ndalemi për të analizuar ankimin ndaj vendimeve të kësaj gjykate.

Tabela nr. 24

Ankimimi i vendimeve dhe rezultati i tij

Vitet	Nr. i Çështjeve penale	Vendime të ankimuara	Lënie në fuqi	Prishje pushim	Prishje kthim	Mospranim	Gjykatë e Lartë	Subjekti që ankimon	
								Prokurori	Gjykuar
2004	29	14	9	1	-	2	10	5	-
2005	24	15	8	-	2	1	8	6	1
2006	18	9	1	1	-	1	1	2	8
Total	71	38	18	2	2	4	19	13	9

Nga 71 vendime të dhëna gjatë periudhës 2004- 2006, është ushtruar e drejta e ankimit ndaj 38 vendimeve ose 53.5 për qind prej tyre. Pas shqyrtimit të tyre, nga Gjykata e Apelit ka rezultuar se, 18 vendime ose 47.3 për qind e tyre janë lënë në fuqi; 2 vendime penale ose 2.8 për qind e tyre janë prishur dhe është vendosur pushimi i gjykimit; 2 vendime ose 2.8 për qind janë prishur dhe është vendosur kthimi i çështjes për rigjykim.

Krahas ankimit në gjykatë të Apelit, një pjesë e vendimeve penale janë dërguar në Gjykatën e Lartë, e cila ka gjykuar gjithsej 19 raste, në 4 në prej të cilave ose 5.6 për qind të tyre, ka vendosur mospranim të rekursit.

Në lidhje me subjektet që kanë bërë ankimin 13 vendime ose 18.3 për qind, janë ankimuar nga Prokurori dhe 9 vendime ose 12.7 për qind janë ankimuar nga të gjykuarit, *pra në shumicën e rasteve ka qenë prokurori që ka bërë ankimin pranë Gjykatës së Lartë.*

KREU VI

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

A. Vlerësime të përgjithshme lidhur me aksesin e publikut dhe transparencën e gjykatave të vëzhguara

1. Përgjithësisht ka përmirësim në punën e gjykatave në drejtim të publikimit të vendimeve gjyqësore në faqen e internetit. Së bashku me vendimin aplikohet edhe publikimi i një kronologjie sqaruese në lidhje me zhvillimin e gjykimit, si dhe të dhëna për akuzën, të pandehurin, statusin e çështjes, numrin e seancave, shkakun e shtyrjes së tyre, afatet e gjykimit etj. Mendojmë se kjo metodë ka sjellë transparencë dhe mundësi që çdo qytetar i interesuar të marrë dijeni lehtësisht, por nga ana tjetër është një instrument për të bërë gjykatën më transparente, të përgjegjshme dhe të vlerësueshme nga publiku, lidhur me zhvillimin e gjyqësorisë penale dhe respektimin e disa prej parimeve të rëndësishme të tij.
2. Konstatojmë gjithashtu se, gjykata ka zbatuar gjykim të shkurtuar, në mjaft raste, çka do të thotë një rritje e efektivitetit të shpejtësisë të proceseve gjyqësore .
3. Nga takimet me përfaqësues të institucioneve të drejtësisë vihet re një rritje e shkallës së ndjeshmërisë së tyre për hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale për korrupsion si dhe një rritje e shkallës së ndërgjegjësimit qytetar në denoncime dhe në bashkëpunimin e tyre me organet e drejtësisë.
4. Duhet vënë në dukje se, nga të tria gjykatat u shpreh shqetësimi për vazhdimësinë e publikimeve në internet, gjë që nuk mund të garantohet nga Buxheti i shtetit. Deri tani ato janë mbuluar nga donatorë të huaj, të cilët kanë dhënë një ndihmesë të konsiderueshme, jo vetëm materiale, por edhe në drejtim të cilësisë së publikimit në Internet. Kjo çështje nuk mund të mbetet një problem i përhershëm i donacioneve të huaja dhe duhet të sigurohet medoemos nga buxheti. Gjykata e Tiranës u shpreh e shqetësuar për vitin në vazhdim, ndërkohë që të dyja gjykatat e tjera kanë filluar të kenë boshllëqe në informacionin që shërbejnë në internet. Nga kontaktet e drejtpërdrejta, i vetmi problem që u shtrua, ishte mungesa e fondeve përkatëse.
5. Shqetësimi i shtruar në pikën 4, lidhet drejtpërdrejt edhe me shqetësimin për botimin e vendimeve të gjykatës. Botimi i rregullt e periodik i vendimeve të gjykatës është një domosdoshmëri dhe kërkesë për rritjen e transparencës, por edhe një kërkesë logjike, në kuadër të standardeve të kërkuara nga marrëveshja e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian.
6. Duhet shtruar çështja e informimit të publikut nga organi i prokurorisë, pavarësisht se ajo mund të shtrohet vetëm në disa aspekte të kufizuara. Faktikisht nga monitorimi ynë, përveç statistikave zyrtare, e kishim të vështirë një akses monitorues, të cilin na e ofruan prokurorët e rretheve përkatëse.

7. Ka një sensibilizim dhe informim të pamjaftueshëm të publikut për kuptimin dhe format e korrupsionit pasiv, si dhe format e shfaqjes së tij në marrëdhënien e shtetasve. Publiku e njeh fare pak ose aspak ligjin. Kjo ndikon drejtpërdrejt në uljen e rasteve të raportimeve prej tij.

B. Vlerësimi lidhur me procedimet disiplinore dhe penale kundër veprave penale të korrupsionit

1. Studimet statistikore tregojnë se perceptimi në lidhje me përhapjen e korrupsionit është shumë më i madh, krahasuar me çështjet në proces ose të gjykuara.
2. Gjithashtu, pavarësisht nga perceptimi i publikut për përmasat e përhapjes së korrupsionit në sektorë të tillë, si ai i tatimeve dhe i doganave, mungojnë pothuajse fare procedimet penale që lidhen me praktika korruptive në këta sektorë të administratës.
3. Masat disiplinore në rastet e abuzimeve me detyrën kanë ardhur në rritje. Organet e ngarkuara me ligj për zbatimin e tyre, duhet të tregojnë më tepër kujdes në evidentimin dhe provueshmërinë e shkeljeve, me qëllim që procedimi të jetë objektiv dhe me efekte parandaluese.
4. Gjatë periudhës 2004-2006, procedimet penale për veprat penale të korrupsionit kanë shënuar një rritje. Vepra penale e shpërdorimit të detyrës zë vendin e parë në grupin e veprave penale të korrupsionit, pavarësisht se mund të ketë edhe raste kur kjo vepër nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me korrupsionin.
5. Megjithëse kanë kaluar rreth dy vjet nga ndryshimet që iu bënë Kodit penal në këtë fushë, numri i procedimeve penale për veprën penale korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259 i k.p) dhe korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë (neni 260 i k.p) është i pakët.
6. Pjesëmarrja e publikut në rritjen e raportimeve nuk është e lartë. Ka një sensibilizim dhe informim të pamjaftueshëm të publikut për kuptimin dhe format e korrupsionit pasiv, si dhe format e shfaqjes së tij në marrëdhënien e shtetasve me funksionarët e të zgjedhurit vendorë.
7. Me gjithë ndryshimet e bëra në kodin penal, zgjerimin e nocionit të korrupsionit aktiv dhe pasiv, ende nuk ka një praktikë gjyqësore të unifikuar, e cila të ndihmojë organin e prokurorisë dhe gjykatën në kuptimin dhe zbatimin e njëjtë dhe të drejtë të përmbajtjes së këtyre dispozitave.
8. Kallëzimet penale, jo gjithnjë kanë cilësinë e kërkuar nga ligji, me qëllim që të përbëjnë bazën e mjaftueshme për fillimin e procedimeve penale dhe dërgimin e çështjeve në gjykatë.

9. Ka një numër të konsiderueshëm të çështjeve penale të pushuara, çka meriton një analizë profesionale e objektive të gjendjes nga institucionet përkatëse, me qëllim që të nxirren shkaqet dhe të bëhen rekomandimet e nevojshme për minimizimin e të metave dhe vështirësive që hasen në praktikë.
10. Ndryshimet e bëra në legjislacionin penal lidhur me veprat penale të korrupsionit, nuk janë shoqëruar aq sa duhet, me zbërthime të përmbajtjes së dispozitave dhe të nocioneve të reja.
11. Ndryshimet e shumta në legjislacionin penal, hera-herës të pakonsultuara më parë me punonjës të praktikës, marrja në mënyrë mekanike e përmbajtjes së konventave ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit, mosqartësimi i dispozitave dhe gjuha e ndërlikuar, janë arsye të tjera që ndikojnë në rënien e efektivitetit të parandalimit dhe të dënimit të veprave penale në këtë fushë.

C. Vlerësimi lidhur me procesin gjyqësor dhe të dhënat që rezultojnë nga vendimet gjyqësore të gjykatave objekt monitorimi

1. Në vitin 2006, në gjykatat objekt-monitorimi, vihet re një rënie e numrit të çështjeve dhe e personave të gjykuar, në krahasim me vitin 2004 dhe 2005.
2. Pjesa më e madhe e personave të proceduar dhe të gjykuar janë meshkuj, me banim në qytet.
3. Personat e grupmoshave 36-55 vjeç, përbëjnë numrin më të madh të personave të gjykuar për veprat penale të korrupsionit.
4. Pjesën më të madhe të gjykuarve, e përbëjnë personat me arsim të lartë.
5. Megjithëse korrupsioni është i përhapur në shumë sektorë të ekonomisë, numri më i madh i të gjykuarve janë punonjës policie dhe punonjës të KESH.
6. Nuk ka asnjë të gjykuar nga organet tatimore ose të doganave, për tre vite të monitoruara.
7. Për veprën penale të Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, ka një numër shumë të vogël të gjykuarish.
8. Gjykatat kanë zbatuar në mënyrë të ekuilibruar masat e sigurimit ndaj personave të proceduar.
9. Nga studimi i vendimeve gjyqësore, rezulton se nga viti në vit, ka përmirësime në mënyrën e arsyetimit të vendimit penal, duke analizuar elementet e kryerjes së veprës penale. Por, ajo që bie në sy është se, pothuajse në të gjitha vendimet e

gjykatës, në politikën penale ndaj të gjykuarit janë mbajtur parasysh nga gjykata vetëm probleme të lidhura ngushtë me autorin e veprës, si: mosha, familja, gjendja ekonomike. Nuk janë mbajtur parasysh probleme të tjera që mund të lidhen me ligjin, apo me problemet e zbatimit të tij, rrethanat e krijuara për këto vepra etj.

10. Nga studimi i vendimeve gjyqësore, nuk u konstatua referimi i drejtpërdrejtë në konventat ndërkombëtare të ratifikuara. Përgjithësisht, gjykatat e konsiderojnë këtë një çështje që duhet të kryhet nga legjislacioni i brendshëm, i cili duhet të përfshijë detyrimet ndërkombëtare në përmbajtjen e tij dhe pak është bërë traditë njohja e drejtpërdrejtë e marrëveshjes, apo zbatimi i saj i drejtpërdrejtë.
11. Nga studimi i vendimeve gjyqësore, u konstatua se nuk pasqyrohej qëndrimi institucional ndaj personit të akuzuar, pra nëse ndaj tij ishin marrë masa disiplinore të karakterit administrativ apo jo. Kjo ka ndodhur vetëm në pak raste të evidentuara në vendimet e dhëna nga gjykata e Vlorës. Ne mendojmë se gjykata duhet ta evidentojë një fakt të tillë me qëllim që të zbatojë një politikë penale më të efektshme.
12. Gjatë monitorimit të disa prej proceseve gjyqësore, të cilat janë në vijim, pranë Gjykatës së Shkallës i Tiranë, nga skuadra e studentëve monitorues, u vunë re shtyrje të seancave gjyqësore. Kjo rezulton edhe nga monitorimi i afateve të proceseve të përfunduara. Shkaqet kryesore për shtyrjen e seancave gjyqësore janë kryesisht, mungesa e prokurorit, mungesa e avokatit, nuk paraqitet dëshmitari, nuk paraqitet i pandehuri që është në gjendje arresti, ose mungon gjyqtari i çështjes.
13. Ka një numër të madh çështjesh të pushuara nga prokuroria dhe dhënie të pafajësisë nga gjykata. Disa shkaqe u parashtruan nga konsultat dhe analizat në rrethet gjyqësore objekt monitorimi. Por, mendojmë se ka nevojë për analiza konkrete të tyre, madje edhe rast pas rasti, në çështjet më tipike, me qarqe profesionistësh dhe ato akademike, të cilat do të ndihmojnë në evidentimin e shkaqeve që çojnë në pushimin e gjykimit dhe dhënien e pafajësisë, por edhe në bërjen e rekomandimeve të nevojshme për përmirësimet ligjore dhe zbatimin e tyre në praktikë, ose për rritjen e efektivitetit të organit të prokurorisë.
14. Nuk ka padi civile në procesin penal në lidhje me dëmin. Nga arsyetimi i vendimeve nuk rezulton që padia civile të jetë veçuar me vendim të ndërmjetëm të gjykatës në procesin e gjykimit penal. Në disa raste, gjykata ka thirrur ekspertë për të përcaktuar saktë dëmin, por ky ka qenë një detyrim për efekt të kualifikimit ligjor të veprës.
15. Në politikën penale nuk janë mbajtur parasysh gjithmonë nga gjykata të gjitha rrethanat, që e favorizojnë ose jo të gjykuarin, në kryerjen e veprës penale.
16. Gjykatat në përgjithësi nuk aplikojnë dënimet plotësuese.
17. Ankimi i vendimeve është zbatuar në një pjesë të konsiderueshme të rasteve. Janë ankimuar 29 vendime, nga të cilat janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, 17 prej tyre. Ndërsa pjesa tjetër e vendimeve ose janë prishur dhe kthyer për rigjykim, ose janë

pushuar, ose është vendosur mospranimi i ankimit. Një pjesë e tyre kanë shkuar për gjykim në Gjykatën e Lartë.

SUGJERIME

A. Në lidhje me procesin e rregullt ligjor në administratën shtetërore

1. Krijimi i gjykatave administrative është më se i nevojshëm në zgjidhjen e drejtë, të shpejtë dhe profesionale të konflikteve të ndryshme. Ato do të ndihmojnë gjithashtu, edhe në parandalimin e veprave penale korruptive. Gjithashtu, do të lehtësojnë çështjet e dërguara në Gjykatat civile e penale, duke ndihmuar në rritjen e profesionalizmit në gjykim.
2. Është i nevojshëm zhvillimi dhe zbatimi i politikave të efektshme dhe të koordinuara mirë nga institucionet shtetërore administrative kundër korrupsionit, në të gjitha shërbimet që i ofrohen publikut, duke nxitur pjesëmarrjen e tij në luftën kundër korrupsionit, si dhe trajtimi i barabartë i të gjithë shtetasve përpara ligjit.
3. Është e këshillueshme që institucionet e administratës shtetërore, në mënyrë sistematike dhe periodike, të vlerësojnë ecurinë e shërbimeve që i ofrojnë publikut dhe të shohin efektivitetin e masave dhe të instrumenteve që përdoren për të parandaluar abuzimet me detyrën. Përzgjedhja më e mirë e punonjësve në emërimin e tyre, kriteret e vlerësimit të punës së tyre, studimi i opinionit të publikut për shërbimet dhe korrektesën e shërbimit të agjencive të ndryshme dhe të punonjësve të tyre, vendosja e disa treguesve të matjes së performancës së punonjësve, bazuar edhe në vlerësimin e shtetasve mund të jenë disa nga instrumentet e minimizimit të abuzimeve dhe të rritjes së cilësisë dhe transparencës me publikun.
4. Hartimi i procedurave të qarta për kryerjen e funksioneve të ndryshme nga funksionarë publikë dhe të zgjedhor vendorë, me qëllim që të shmangen abuzimet dhe ligji të kuptohet dhe të zbatohet në mënyrë të njëjtë dhe korrekte nga të gjithë. Ligjet për prokurimin publik dhe administrimin e financave duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë. Është të nevojshme përgatitja e manualeve shpjeguese dhe sqaruese.
5. Forcimi i auditit të brendshëm dhe Kontrollit të Jashtëm të Shtetit do të ndihmojë në parandalimin e korrupsionit.
6. Parandalimi i korrupsionit kërkon që në përzgjedhjen e punonjësve të shërbimit publik dhe emërimet e ndryshme në administratën publike, të respektohen parimet e efencës, transparencës, meritokracisë dhe aftësisë, duke parandaluar

kështu rastet e militantizmit, të nepotizmit dhe të konfliktit të interesit. Anshmëritë politike në emërime, si dhe mungesa e garancisë në qëndrimin në detyrë në administratën publike, vazhdon të mbetet rrezik për korrupsionin. Ajo bëhet burim papërgjegjshmërie dhe krijon nxitje për sjellje korruptive. Për pasojë duhet të forcohen mekanizmat e kontrollit, të rriten garancitë e palëvizshmërisë në detyrë, si dhe të lehtësohen procedurat demokratike në veprimtarinë e administratës publike.

7. Është i nevojshëm informimi dhe trajnimi i personave që administrojnë vlera materiale dhe financiare rreth procedurave të prokurimeve dhe tenderimeve. Qartësimi i procedurave do të ndikojë pozitivisht në zbatimin e drejtë të ligjit.
8. Parandalimi i korrupsionit në sektorin privat kërkon që të forcohen standardet e kontabilitetit dhe të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.
9. Sensibilizimi i publikut për rrezikun që paraqet korrupsioni për sigurinë dhe demokracinë në një vend, si dhe për institucionet e vendit është një domosdoshmëri.
10. Universitetet dhe qendrat e pavarura të kërkimit shkencor luajnë një rol me rëndësi në monitorimin e kuptimit dhe të zbatimit të ligjit dhe të mekanizmave të krijuara për parandalimin e korrupsionit dhe veprimeve të tjera abuzive. Rritja e pjesëmarrjes së tyre në monitorimet e veprimtarisë së institucioneve dhe të informimit të publikut është i dobishëm.
11. Për vetë natyrën e tij sociale dhe ekonomike, lufta ndaj korrupsionit nuk mund të këtë kuptim pa përfshirjen e politikave parandaluese. Pavarësisht nga masat represive ligjore, ky fenomen do të vazhdojë të jetë prezent nëse nuk zhduken shkaqet e tij. Për këtë arsye një vend të veçantë në politikat qeveritare duhet të zënë masat ekonomiko- sociale, me qëllim zhdukjen e varfërisë si dhe rritjen e mirëqenies.
12. Përfshirja e shoqërisë civile si dhe rritja e rolit të medias gjithashtu është me mjaft rëndësi në drejtim të sensibilizimit dhe rritjes së ndërgjegjes qytetare në drejtim të denoncimit të rasteve të korrupsionit.

B. Në lidhje me procesin e rregullt gjyqësor

1. Rritja e rolit të gjykatës për zgjidhjen e shpejtë, me procedurë të shkurtuar të konflikteve mes shtetasve dhe punonjësve që abuzojnë, është një mundësi tjetër për të rritur besimin e publikut te institucionet dhe rritjen e bashkëpunimit të tij në luftën kundër korrupsionit.

2. Hartimi i qartë dhe i saktë i dispozitave të kodit penal, do të bënte të mundur dallimin më të mirë mes shkeljeve administrative dhe veprimeve që përmbajnë elementë të veprës penale.
3. Rritja e cilësisë së kallëzimeve penale dhe koordinimi mes institucioneve të ndryshme, me atë të prokurorisë është i nevojshëm për një goditje të veprave penale të lidhura me korrupsionin dhe për parandalimin e tyre.
4. Është i nevojshëm trajnimi vazhdues i oficerëve të policisë gjyqësore, prokurorëve dhe gjyqtarëve në fushën e veprave penale të korrupsionit. Zhvillimi i praktikës dhe trajnimi i personelit të seksioneve të krimit ekonomik pranë prokurorisë janë një domosdoshmëri.
5. Analiza e problemeve dhe e mangësive që vihen re në hetimin dhe gjykimin e veprave penale në fushën e korrupsionit nga punonjës të teorisë dhe të praktikës, do të ndikojë në përmirësimin e praktikës, sqarimin e kuptimeve jo të qarta të përmbajtjes së disa neneve të kodit penal dhe ligjeve të tjera penale të miratuara kohët e fundit në këtë fushë.
6. Politizimi i rasteve të paraqitura në prokurori, cenimi i prezumimit të pafajësisë nga media dhe përfaqësues të politikës, ndikon negativisht në efektivitetin e luftës kundër korrupsionit. Është e këshillueshme që në parandalimin e korrupsionit të bashkëpunohet dhe të koordinohen përpjekjet, duke ruajtur pavarësinë dhe kompetencat e institucioneve.
7. Organi i prokurorisë dhe sistemi gjyqësor e kanë të nevojshme përmirësimin e sistemit të vlerësimit të punës së prokurorit dhe të gjyqtarit me qëllim që të shmangen veprimet e abuzimeve me ligjin dhe rastet e korrupsionit mes tyre.

ANEX 1

KODI PENAL (VEPRAT PENALE PËRKATËSE)

Veprat penale që lidhen me korrupsionin:

Neni	Vepra penale	Sanksioni
Neni 187	Falsifikimi i dokumenteve shkollore 1. Falsifikimi apo përdorimi i dokumenteve të falsifikuar 2. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin	(1) Dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet (2) Dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet
Neni 188	Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore 1. Falsifikimi apo përdorimi i dokumenteve të falsifikuara shëndetësore 2. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin	1. Dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet 2. Dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet
Neni 189	Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose vizave 1. Falsifikimi ose përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave apo i vizave të falsifikuara 2. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda 3. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën apo vizën	1. Dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 400 mijë deri në 1 milion lekë 2. Dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet dhe me gjobë nga 600 mijë deri në 2 milion lekë 3. Dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet dhe me gjobë nga 1 milion deri në 3 milion lekë
Neni 190	Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve 1. Falsifikimi ose përdorimi i vulave, i stampave apo i formularëve të falsifikuar ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit, që u drejtohen organeve shtetërore 2. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda 3. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë hartimin e tyre	1. Dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 400 qind mijë deri në 1 milion lekë 2. Dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet dhe me gjobë nga 600 mijë lekë deri në 2 milion lekë 3. Dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet dhe me gjobë nga

		<i>1 milion deri në 3 milion lekë.</i>
Neni 191	Falsifikimi i akteve të gjendjes civile 1. Falsifikimi apo përdorimi i akteve të gjendjes civile të falsifikuara 2. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda 3. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë aktin	1. Dënohet me burgim nga 3 muaj deri në 2 vjet dhe me gjobë nga 300 mijë lekë deri në 600 mijë lekë 2. Dënohet me burgim nga 6 muaj deri në katër vjet dhe me gjobë nga 500 mijë deri në 1 milion lekë 3. Dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet dhe me gjobë nga 1 milion deri në 3 milion lekë.
Neni 244	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën ose funksionin e tij	Dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet dhe me gjobë nga 300 mijë lekë deri në 1 milion lekë
Neni 245	Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij	Dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet dhe me gjobë nga 500 mijë lekë deri në 2 milion lekë
Neni 245/1	Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike 1. Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtan ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj 2. Kërkimi marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për te ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që	Dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 2 vjet dhe me gjobë nga 300 mijë lekë deri 1 milion lekë 2. Dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 500 mijë deri në 2 milion lekë

	<i>ushtrojnë funksione publike</i>	
Neni 248	Shpërdorimi i detyrës <i>Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjelle atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë</i>	<i>Dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet dhe me gjobë nga 300 mijë lekë deri në 1 milion lekë</i>
Neni 256	Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti <i>Shpërdorimi i kontributeve, subvencioneve ose financimeve të dhëna nga shteti ose institucione shtetërore, për tu përdorur në vepra dhe veprimtari me interes publik</i>	<i>Dënohet me gjobë ose me burgim gjer në 3 vjet</i>
Neni 259	Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike <i>Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij.</i>	<i>Dënohet me burgim nga 2 deri në 8 vjet dhe me gjobë nga 500 mijë deri në 3 milion lekë</i>
Neni 260	Korrupsioni pasiv i funksionareve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë <i>Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor për të kryer a mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij</i>	<i>Dënohet me burg nga 4 deri në 12 vjet dhe me gjobë nga 1 milion deri në 5 milion lekë</i>

Neni 319	Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë <i>Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim</i>	<i>Dënohet me burgim nga 1 vit deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 400 mijë lekë deri në 2 milionë lekë</i>
Neni 319/a	Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë. <i>Kërkimi ose marrja, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e tij</i>	<i>Dënohet me burgim nga 3 deri në 10 vjet dhe me gjobë nga 800 mijë deri në 4 milion lekë</i>
Neni 328	Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve <i>Ofrimi ose dhënia e të hollave, bërja e premtimeve për vende pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë</i>	<i>Dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj</i>

ANEX 2

*Eseja e përgatitur nga studenti i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës,
Albana Alimema*

*Vlerësuar me çmimin e parë në konkursin e organizuar me ese të përgatitura nga
studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.*

“Korrupsioni në Shqipëri: shkaqet, pasojat dhe lufta ndaj tij nëpërmjet zbatimit të legjislacionit”

1. Hyrje

Korrupsioni është një dukuri shumëdimensionale dhe po aq i vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Është në natyrën e vetë njeriut që të mundohet të krijojë privilegje dhe përfitime personale pa marrë parasysh nevojat e të tjerëve, qoftë edhe në disfavor të tjerëve. Në këtë kuptim nuk përjashtohen as segmente të shoqërisë shqiptare.

Konteksti i sotëm i korrupsionit në Shqipëri mund të karakterizohet si rezultante e sistemit politik dhe shoqërorë para viteve '90 dhe gjendjes së tejzgjatur të tranzicionit, në veçanti edhe të rrethanave të vitit 1997 dhe rrjedhave të mëpasshme politike dhe ekonomike. Po ashtu nuk duhet anashkaluar edhe fakti që Shqipëria ndodhet në një rajon me nivel të lartë korrupsioni. Të gjitha këto kanë krijuar një mjedis të përshtatshëm për korrupsion në të gjitha nivelet institucionale dhe jointitucionale.

Shkaqet, pasojat dhe lufta ndaj korrupsionit kanë qenë gjithnjë objekt studimesh dhe diskutimesh të shumta në radhët e studiuesve, politikanëve dhe aktorëve të tjerë që merren me këto probleme, duke mos lenë jashtë edhe segmente të shoqërisë civile. Këto përbëjnë edhe objektin e këtij punimi, por të parë në këndvështrimin tim jo si profesionist por si një student që bashkohet me shqetësimin e përgjithshëm mbi këtë fenomen.

2. Një përkufizim mbi korrupsionin

Përpara se të kalojmë në trajtimin e atyre çështjeve që sapo parashtrova më lartë, më duket e arsyeshme që të jap një përkufizim mbi korrupsionin, si pikënisje në trajtimin e problemit.

Përkufizimi më gjerësisht i pranuar i korrupsionit është si “ abuzim me detyrën për përfitime personale”(korrupsioni në kuptimin e gjerë).

Ndërsa, në përpjekje për të gjetur një përkufizim më të ngushtë të korrupsionit mund ta përkufizojmë atë si “ *çdo shkelje të detyrës të personave zyrtarë ose personave përgjegjës të subjekteve juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shërbimi që drejtpërdrejtë ose indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t’u marrë për veten apo për një person tjetër*”. Siç shihet ky përkufizim përfshin korrupsionin aktiv dhe pasiv të personave zyrtarë që mbajnë një funksion publik ose ushtrojnë një shërbim publik, të personave përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e shoqërive tregtare si dhe të personave që janë iniciatorë të sjelljeve korruptive.

3. Shkaqet e korrupsionit në Shqipëri

Shkaqet apo faktorët që ndikojnë në lindjen dhe shtrirjen e gjerë të korrupsionit mund t'i ndajmë në shkaqe të përgjithshme dhe të veçanta.

a) Shkaqet e përgjithshme

Në shkaqe të përgjithshme përfshihen të gjithë ata faktorë të cilët janë të njëjtë për një grup shtetesh apo rajoni me zhvillim të njëjtë ekonomik, social dhe politik dhe që ndikojnë në mënyrë indirekte në lindjen dhe shtrirjen e korrupsionit. Kështu duke i'u referuar një raporti të Transparency International(TI) vendet në zhvillim dhe pjesa më e madhe e vendeve të Ballkanit karakterizohen nga një nivel i lartë korrupsioni.

Karakteristikat e përbashkëta për këto shtete janë:

- Shumica e këtyre vendeve kanë përjetuar totalitarizmin në të kaluarën dhe/ose kanë pasur konflikte civile;
- Edhe pse shumica kanë qeveri të zgjedhura dhe karakterizohen si vende demokratike, institucionet e tyre demokratike janë në shkallë të ndryshme të zhvillimit;
- Papunësia është e lartë, kurse shteti tenton të zvogëlojë papunësinë duke hapur vende të reja pune në sektorët e shërbimeve/sectorët publik;
- Të punësuarit kanë paga të vogla dhe shumica e tyre mund të konsiderohen se jetojnë nën ose në kufirin e varfërisë;
- Shoqëria civile dhe mediat janë të pazhvilluara ose të dobëta.

b) Shkaqet e veçanta

Shkaqet e veçanta janë faktorët të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në lindjen dhe shtrirjen e korrupsionit dhe që janë specifik për çdo shtet. Sipas një sondazhi të UNDP-së të vitit 2004, shkaqet apo rrethanat që favorizojnë korrupsionin në shoqërinë shqiptare janë: pagat e ulëta të zyrtarëve në sektorin publik, dëshira për pasurim të shpejtë personal, kriza morale, mosefikasiteti i sistemit gjyqësorë dhe legjislacioni i pakompletuar. Përveç këtyre ka edhe faktorë të tjerë që favorizojnë korrupsionin të cilët shtrihen në nivelin e qeverisjes lokale: mungesa e transparencës në lidhje me vendimmarrjen, tenderat dhe hartimin e buxhetit lokal, nepotizmi, çështjet e pazgjidhura pronësore, mungesa e monitorimit nga ana e qytetarëve etj; në nivelin e qeverisjes qendrore: mungesa e transparencës, mos deklarimi i pasurisë nga funksionarët politik, problemet me prokurimet publike, mungesa e llogaridhënies dhe kontrollit nga organet qendrore dhe institucionet në vartësi të tyre; si dhe në nivelin e parlamentit: mosdeklarimi i pasurive apo deklarimi i rremë i tyre nga deputetët, konflikti i interesave, mosbërja transparente e burimit të financimit të partive etj.

Më lartë rendita një sërë faktorësh që ndikojnë në lindjen e korrupsionit apo favorizojnë atë, por që nuk janë të vetmit, pasi korrupsioni është një dukuri shumëdimensionale dhe për të gjetur shkaqet e tij nevojitet një studim shumë i thellë dhe profesional që do të kërkonte një kohë shumë herë më të madhe se ajo që nevojitet për t'i pasqyruar ato në disa rreshta.

4. Pasojat e korrupsionit

Duke qenë një fenomen negativ për çdo shoqëri, korrupsioni shoqërohet edhe me pasoja negative në segmente të caktuara të shoqërisë.

Pasojat e korrupsionit mund t'i ndajmë në pasoja ekonomike, sociale dhe politike.

a) Pasojat ekonomike

Përvoja ka treguar se korrupsioni ka dy pasoja kryesore mbi zhvillimin ekonomik. E para, meqenëse suksesi ekonomik varet kryesisht nga shpërndarja optimale e burimeve, ndryshimi i destinacionit të fondeve, nëpërmjet aktiviteteve të korruptuara të menaxherëve dhe zyrtarëve përfaqëson një çrregullim të shpërndarjes dhe rrjedhimisht redukton burimet e disponueshme për rritje ekonomike. E dyta, korrupsioni frikëson investitorët dhe dekurajon investimet e huaja direkte duke zvogëluar kështu përdorimin e një burimi kapitali jetësor.

b) Pasojat sociale

Pasojat sociale të korrupsionit janë të shumta, por ato më të rëndësishmet dhe që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me pasojat ekonomike të korrupsionit janë: e para, ulja e nivelit të jetesës për pjesën më të madhe të popullsisë, pasi duke ndryshuar destinacionin e fondeve, krijohet një hendek midis dy grupeve atyre që përfitojnë nga korrupsioni (që janë një numër i vogël krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë) dhe pjesës tjetër të popullsisë (taksapaguesve apo atyre që përfitojnë subvencione nga shteti) të ardhurat e të cilëve ulen me rritjen e nivelit të korrupsionit duke ulur në këtë mënyrë nivelin e tyre të jetesës (në Shqipëri një pjesë e mirë e tyre jetojnë nën ose në nivelin e varfërisë); e dyta, rritja e kriminalitetit, jo vetëm sepse korrupsioni në vetvete, përbën një vepër penale, por edhe sepse ndikon, indirekt, në rritjen e veprave të tjera penale si vjedhja. Këtë mund ta konstatojmë fare lehtë po të kemi parasysh të dhënat statistikore në lidhje me kriminalitetin në Shqipëri. Kështu numrin më të madh të veprave penale e përbën vjedhja, në të gjitha format e saj, duke u pasuar nga vepra të tjera midis të cilave edhe veprat korruptive¹⁹. Nga ana subjektive motivi i kryerjes së veprës penale të vjedhjes është përfitimi ekonomik. Duke qenë se me rritjen e shkallës së korrupsionit ulet niveli i të ardhurave për pjesën më të madhe të popullsisë, do të kemi një rritje të predispozicionit për kryerjen e vjedhjes si një alternativë për të siguruar të ardhura për jetesë.

c) Pasojat politike

Pasoja kryesore politike e korrupsionit është ulja e besimit të qytetarëve ndaj qeverisjes në përgjithësi dhe qeverisë në veçanti si përgjegjësjë kryesore për nivelin e korrupsionit. Por nga ana tjetër ulja e besimit ndaj qeverisjes dhe qeverisë shoqërohet me pasoja të rënda për shoqërinë që lidhen me forcimin dhe respektimin e shtetit të së drejtës dhe shtetit social, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore etj. Si shembullin më të mirë mund të sjellim korrupsionin në sistemin e drejtësisë, i cili ul ndjeshëm besimin qytetarëve ndaj organeve të drejtësisë, gjë e cila është mjaft e dëmshme për demokracinë e një vendi, pasi lidhet drejtpërdrejtë me respektimin e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës. Këto të fundit mund të shihen si pasoja indirekte politike të korrupsionit.

¹⁹ Themi veprat korruptive pasi, këtu nuk përfshihen vetëm korrupsioni aktiv dhe pasiv por edhe vepra të tjera penale si shpërdorimi i detyrës etj.

5. Lufta ndaj korrupsionit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit.

Duke e cilësuar korrupsionin si një pengesë për stabilitetin ekonomik, shtetin e së drejtës dhe zhvillimin ekonomik dhe atë social në Shqipëri, edhe përpjekjet për ta luftuar atë nuk kanë munguar dhe kanë qenë të vazhdueshme. Natyrisht që kjo luftë nuk mund të jetë spontane dhe sporadike por kërkon hartimin e një strategjie dhe ngritjen e strukturave të specializuara anti-korrupsion.

Eksperienca tregon se strategji të tilla kanë më shumë mundësi për të qenë të suksesshme nëse ato përmbajnë tre elementë, të cilët janë të lidhur ngushtë me njëri tjetrin:

- Zbatimi i legjislacionit
- Parandalimi
- Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut në përpjekjet anti-korrupsion

Me gjithë rëndësinë që kanë të tre këto elementë në këtë punim do të trajtojmë vetëm të parin, pra zbatimin e legjislacionit si mjet më efektiv në luftën kundër korrupsionit.

Me ndryshimet demokratike të pas viteve '90 dhe rrjedhave të mëpasshme politiko-ekonomike, ishte e nevojshme hartimi i një kuadri legjislativ të ri që do t'i përshtatej rrethanave të reja politike dhe ekonomike. Po ashtu aspirata për aderimin në Bashkimin Evropian kërkon, ndër të tjera, reforma në fushën legjislative, siç është përafrimi i legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së (acquis communautaire). Për të triumfuar në përpjekjet e tyre për anëtarësimin në BE, shtetet candidate (midisi tyre edhe vendi ynë) duhet jo vetëm të përshtatin acquis communautaire, por edhe ta zbatojnë atë. Kjo iu kërkon që të investojnë shumë për një administratë profesionale, për krijimin e institucioneve dhe procedurave që do të mbështesin zbatimin praktik të legjislacionit ekzistues dhe të afta për ta përshtatur me legjislacionin e së ardhmes së parashikueshme.

Por në përpjekjet e tyre për zbatimin e legjislacionit, mund të krijohet një hendek zbatimi, i cili është deficieti ndërmjet një sërë normash ligjore dhe kapacitetit për ti vënë në jetë dhe për t'i zbatuar ato sipas standardeve demokratike. Siç edhe e kemi theksuar, një hendek zbatimi do të favorizojë korrupsionin. Prandaj është e nevojshme jo vetëm krijimi i institucioneve dhe procedurave që do të sigurojnë zbatimin praktik të legjislacionit por edhe ushtrimi i një kontrolli mbi masën e zbatimit të legjislacionit. Një rol të madh në këtë drejtim luajnë organet e drejtësisë dhe organet e auditit.

Organet e drejtësisë sidomos prokuroria dhe policia gjyqësore, kanë kompetenca të plota për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave që lidhen me korrupsionin. Lufta ndaj korrupsionit varet në një masë të madhe nga efektiviteti në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale korruptive nga organet e ndjekjes penale. Po ashtu edhe gjykata kanë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, pasi gjykimi me drejtësi dhe paanshmëri i çështjeve penale që paraqiten para tyre do të rrisë besimin e qytetarëve mbi punën e tyre, çka do të sjellë edhe rritjen e denoncimeve të veprave korruptive nga ana e tyre.

Organet e auditit, janë një hallkë shumë e rëndësishme e sistemit të kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit. Këtu mund të futen kryesisht organe që kanë në kompetencë kontrollin e jashtëm mbi veprimtarinë administrative si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive etj.

Rolin më të madh në këtë drejtim e kanë vetë qytetarët duke zbatuar vullnetarisht ligjin. Arritja e synimeve të politikave të ndjekura nga administrata publike varet në një masë të madhe nga përshtatja vullnetare e qytetarëve dhe ndërmarrjeve me legjislacionin. Një shembull është mbledhja e taksave mbi të ardhurat kur taksapaguesit individualë

marrin përsipër llogaritjen dhe transferimin e shumave të detyruara. Në këtë kontekst, efekti kryesorë që kërkohet të arrihet, është të shmanget moszbatimi dhe të përforcohet vullneti për ta zbatuar tek pjesa më e madhe e atyre që nuk zbatojnë ligjin si mjeti më i mirë për të luftuar korrupsionin.

6. Konkluzione

Si përfundim, mund të themi se korrupsioni është një fenomen që ka lindur me njerëzimin dhe do të zhduket bashkë me të. Por, duke qenë një ulçër e të gjitha shoqërive, që shkaktohet nga rrethana të përgjithshme të natyrës njerëzore dhe nga faktorë të veçantë që pasqyrojnë zhvillimin dhe natyrën e një shoqërie të caktuar, dhe që shoqërohet me pasoja negative të natyrës ekonomike, sociale dhe politike, lufta ndaj tij mbetet përherë një sfidë e hapur dhe mjeti më efektiv për ta realizuar është zbatimi praktik i legjislacionit. Në këtë drejtim, protagonistë janë vetë qytetarët, duke zbatuar vullnetarisht ligjin, për shkak të besnikërisë ndaj tij. Por kurdoherë, mbetet e hapur mundësia e moszbatimit nga të ashtuquajturit “kalorësit e lirë” (free-rider), të cilët mundohen të përfitojnë nga praktikatat e institucionalizuara duke mos kontribuar në to, dhe në këtë rast del në pah roli i organeve që merren drejtpërdrejtë me zbatimin e legjislacionit dhe atyre që kontrollojnë këtë zbatim dhe vënë në vend pasojat që rrjedhin nga ky moszbatim.

Vlerësimi i Jurisë së konkursit “Eseja më e mirë e studentit të drejtësisë”, për esenë e përgatitur nga studenti Alban Alimema.

Tema e përgatitur nga studenti Alban Alimema me temë “*Korrupsioni në Shqipëri, shkaqet, pasojat dhe lufta ndaj tij nëpërmjet zbatimit të legjislacionit*”, mendojmë se është tema më e arrirë nga të gjitha pikëpamjet.

Kjo temë dallohet për qartësi dhe saktësi në konceptet e paraqitura, logjikë dhe koherencë në strukturën e ndërtimit të temës, fjalor të thjeshtë dhe njëkohësisht profesional. Studenti ka paraqitur një situatë reale të shkaqeve të korrupsionit në Shqipëri, të pasojave që ky fenomen sjell për shoqërinë shqiptare, si dhe të mënyrave që duhen përdorur për ta luftuar me sukses. Sidoqoftë, sugjerojmë që tema mund të ishte shoqëruar me ndonjë shembull nga jeta dhe praktika e përditshme.

Përsa më sipër, mendojmë se esesa e përgatitur nga studenti Alban Alimema duhet vlerësuar si tema më e mirë, e cila meriton 30 pikë (Çmimi i I-rë), si dhe si tema që meriton të marrë dhe çmimin special për temën e shkruar më qartë e të vlefshme për botim.

Juria e përbërë nga:

- 1. Arben Kraja, Prokuroria e Përgjithshme***
- 2. Petrit Çomo, Nën Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë***
- 3. Gentjan Osmani, Gentian Osmani, Prokuroria Tiranë***

Anex 3: FALENDERIME TË GJITHË SPECIALISTËVE DHE STUDENTËVE TË POSHTËSHËNUAR, QË KONTRIBUAN PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE TË KËTIJ PROJEKTI

Albert Meçe, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë
Artur Malaj, Gjykata së Rrethit Gjyqësor, Vlorë
Valbona Duraj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër
Petrit Çomo, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë
Artur Gaxhi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë
Migena Laska, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë
Klodiana Gjyzeli, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë
Marinela Nuni, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë
Elvana Çiçolli, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë
Albert Pashaj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë
Aleks Nikolli, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër
Fuat Vjerdha, Gjykata e Apelit, Shkodër
Vexhi Mucmata, Prokuror i Rrethit, Tiranë
Petrit Cani, Prokuror i Rrethit, Vlorë
Fatjona Memçaj, Prokuroria e Rrethit, Tiranë
Ervin Karanxha, Prokuroria e Rrethit, Tiranë
Gentjan Osmani, Prokuroria e Rrethit, Tiranë
Armand Gurakuqi, Prokuroria e Rrethit, Tiranë
Liljana Gjomema, Prokuroria e Rrethit, Vlorë
Eranda Felaj, Prokuroria e Rrethit, Vlorë
Skënder Dautaj, Prokuroria e Rrethit, Vlorë
Kleanth Zeka, Prokuroria e Rrethit, Vlorë
Pëllumb Prençi, Prokuroria e Rrethit, Shkodër
Ajola Ymeri, Prokuroria Shkodër
Arben Kraja, Prokuroria e Përgjithshme
Rozeta Shkëmbi, Këshilli i Lartë i Drejtësisë
Dhimitrulla Spiro, ILDKP/ Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive
Ermela Zaimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë
Valbona Hoxha, Gjykata e Apelit, Shkodër
Daniela Kristo-Nesho, Gjykata e Lartë
Mirela Miljori, Dhoma e Avokatisë, Vlorë
Arsen Zotaj, Dhoma e Avokatisë, Vlorë
Nereida Binaj, Dhoma e Avokatisë, Vlorë
Emirtela Aliaj, Dhoma e Avokatisë, Vlorë
Alketa Agolli, Dhoma e Avokatisë, Vlorë
Dhurata Sulaj, Dhoma e Avokatisë, Vlorë
Ilir Zoto, Dhoma e Avokatisë, Vlorë
Fabiola Hysenaj, Dhoma e Avokatisë, Shkodër
Olivia Hoxha, Dhoma e Avokatisë, Shkodër
Gjon Voci, Dhoma e Avokatisë, Shkodër
Laureta Dervishi, Komisariati i Policisë, Vlorë
Gjergji Nikolla, Komisariati i Policisë, Vlorë

Petro Thanasko, Jurist
Tedi Nasto, Jurist
Ledina Malaj, Notere, Vlorë
Erion Laze, Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme, Vlorë
Besnik Kastrati, Bashkia, Shkodër
Oriola Caku, juriste, Shkodër
Valbona Duraj, Gjykata e Apelit, Shkodër
Elona Reçi, IFC/Banka Botërore
Arjeta Plaku, CAO/ Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, Shkodër
Arben Saraçi, CAO/ Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, Shkodër
Admiranda Tafa, Klinika Ligjore për të Miturit, Shkodër
Klodi Kajashi, CAO/ Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, Shkodër
Eva Baja, Klinika Ligjore për të Miturit
Tonin Marku, Klinika ligjore për të Miturit, Shkodër
Arlinda Bilali, CAO/ Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve Shkodër
Rezarta Zaja, CAO/ Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve Shkodër
Marjana Papa, CAO/ Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, Tiranë
Gaspër Kokaj, Dekan i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Shkodër
Skënder Kaçupi, Përgjegjës i Departamentit të së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë,
Vasilika Hysi, Pedagogë, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranë
Altin Shegani, Pedagog, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranë
Jola Xhafo, Pedagogë, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranë
Anila Canaj, Pedagogë, Universiteti Vlorë
Eriola Hoxha, Pedagogë, Universiteti Vlorë
Klajdi Mone, Pedagog, Universiteti Vlorë
Enkeleida Petanaj, Pedagogë, Universiteti Vlorë
Ervin Baçaj, Pedagog, Universiteti Vlorë
Dhimitër Mici, Pedagog, Universiteti Vlorë
Linda Durgaj, Pedagogë, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Shkodër
Afërjona Lohja, Pedagogë, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Shkodër
Ledina Mandia, Pedagogë, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Shkodër

Alban Alimema, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës,-Fitues i çmimit të parë, në konkursin “Eseja më e mirë e studentit të drejtësisë”.

Arbër Kaci, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, -Fitues i çmimit të dytë, në konkursin “Eseja më e mirë e studentit të drejtësisë ”

Erind Mërkuri, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Fitues i çmimit të tretë, në konkursin “Eseja më e mirë e studentit të drejtësisë”,

Ina Muçaj, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Fituese e çmimit special, për temën e shkruar më qartë, në konkursin “Eseja më e mirë e studentit të Drejtësisë”

Edlira Kapllani, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Fituese e çmimit inkurajuaes, në konkursin “Eseja më e mirë e studentit të Drejtësisë”

Rozeta Fejzulla, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Noel Veizi, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Erinda Meli, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Aldi Brisku, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Foto Gjati, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Arjola Sheri, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Fatjon Dhame, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Almona Bajrami, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Edmond Ibrahim, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Eni Kotini, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Ina Petro, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Ilda Muçmata, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Tidita Fshazi, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Julis Zebi, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Sokrat Mitre, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Valbona Hajce, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Matilda Qesja, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Ledio Sali, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Roland Deda, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Mirlind Shkurti, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Jonida Balla, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Elka Dafa, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodër
Arbër Raja, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodër
Anila Pjetri, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodër
Renato Marku, Student i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodër
Emila Subashi, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodër
Erisa Skara, Studente e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodër

Anex 4: FOTO NGA AKTIVITETET E ORGANIZUARA



Pamje nga Tryeza e Rrumbullakët me temë: “Për një zbatim më të mirë të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”, organizuar në Vlorë, më 30.03.2007.



Pamje nga Tryeza e Rrumbullakët me temë: “Për një zbatim më të mirë të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”, organizuar në Shkodër, më 06.04.07.



Pamje nga Tryeza e Rrumbullakët me temë: “Për një zbatim më të mirë të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”, organizuar në Shkodër, më 06.04.07:



Pamje nga Tryeza e Rrumbullakët me temë: “Për një zbatim më të mirë të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”, organizuar në Tiranë, më 13.04.07.



Pamje nga Tryeza e Rrumbullakët me temë: “Për një zbatim më të mirë të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”, organizuar në Tiranë, më 13.04.07.



Pamje nga Tryeza e Rrumbullakët me temë: “Për një zbatim më të mirë të legjislacionit shqiptar, si mjeti më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit”, organizuar në Tiranë, më 13.04.07.